

**Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e
Legjislacionit Mjedisor**

Projekt për Shqipërinë financuar nga Bashkimi Evropian

Projekt VKM për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit ⁽¹⁾

**Drafti 1
Versioni 1**

Datë 22 Nëntor 2010

SHËNIM – Termat “Ministër” dhe “Ministri” përdoren në këtë projekt VKM pasi kështu është thënë në Ligjin për Ajrin. – Mundet që disa nga këto detyra t'i jepen AKM?

¹ Ky Vendim transponon Direktivën 2008/50/EC për cilësinë e ajrit të ambjentit dhe ajrit më të pastër për Evropën dhe Direktivën 2004/107/EC në lidhje me arsenikun, kadmiumin, mërkurin, nikelin dhe hidrokarburet policiklike aromatike në ajrin e ambjentit.



Republika e Shqipërisë

Këshilli i Ministrave

VENDIM

Nr _____, datë ____/____/2010

**PËR
MENAXHIMIN E CILËSISË SË AJRIT**

Në mbështetje të Nenit 59 paragrafi 1.d dhe 100 të Kushtetutës dhe Nenit 5 të Ligjit Nr 8879, datë 16.05.2002 “Për Mbrojtjen nga Ndotja e Ajrit”, Këshilli i Ministrave;

VENDOSI

Pjesa Një

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky Vendim ka si objekt të përcaktojë vlerat kufi, vlerat prag dhe vlerat e synuara për disa ndotës në ajër, të hartojë metodologjitë dhe procedurat për monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit, të përcaktojë kërkesat për vlerësimin paraprak të cilësisë së ajrit dhe kërkesat për planet e cilësisë së ajrit.

II. PËRKUFIZIME

2. Termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:
 - a. Termat e mëposhtëm kanë kuptimin që u është dhënë nga Ligji “Për Mbrojtjen nga Ndotja e Ajrit”;
 - i. “Mjedisi i ajrit”
 - ii. “Ndotës”
 - iii. “Nivel”
 - iv. “Vlerësim”
 - v. “Vlerë kufi”
 - vi. “Plan i cilësisë së ajrit”
 - vii. “Vlerë e synuar”
 - viii. “Sinjalizim i pragut” [Alarm i pragut]
 - ix. “Agregat” [Zonë]
 - b. “**Nivel kritik**” është niveli i fiksuar në bazë të njohurive shkencore, mbi të cilin mund të ndodhin efekte negative të

- drejtpërdrejta tek disa receptorë, siç janë pemët, bimët e tjera apo eko-sistemet natyrore, por jo tek njerëzit;
- c. **“Marzh i tolerancës”** është përqindja e vlerës kufi me të cilën ajo vlerë mund të tejkalohet në varësi të kushteve të parashtruara në këtë Vendim;
 - d. **“Pragu i informacionit”** është niveli përtej të cilit ekziston një rrezik për shëndetin e njeriut nga ekspozimi i shpejtë për seksionet e popullsisë veçanërisht të ndjeshme dhe për të cilin nevojitet informacion i menjëhershëm dhe i përshtatshëm;
 - e. **“Pragu i sipërm i vlerësimit”** është niveli nën të cilin kombinimi i masave të fiksuara dhe teknikat e modelimit dhe/ose masat treguese mund të përdoren për të vlerësuar cilësinë e ajrit të ambjentit;
 - f. **“Pragu i poshtëm i vlerësimit”** është niveli nën të cilin teknikat e modelimit ose vlerësimit objektiv vetëm mund të përdoren për të vlerësuar cilësinë e ajrit të ambjentit;
 - g. **“Objektiv afat-gjatë”** është niveli që duhet arritur në periudhë afatgjatë, në rastet kur nuk është i arritshëm nëpërmjet masave të balancuara, me qëllim sigurimin e mbrojtjes efektive të shëndetit të njeriut dhe mjedisit;
 - h. **“Kontribute nga burimet natyrore”** janë shkarkimet e ndotësve që nuk shkarkohen drejtpërsëdrejti apo jo drejtpërsëdrejti nga aktivitetet njerëzore, përfshirë dukuritë natyrore si shpërthimet vullkanike, aktivitetet sizmike, aktivitetet gjeotermike, zjarret e egra tokësore, dukuritë me erëra të forta, spërkatjet detare apo ri-lëniat pezull atmosferike apo transporti i grimcave natyrore nga rajonet e thata;
 - i. **“PM-10”** janë grimcat e materies që kalojnë nëpërmjet një hyrjeje përzgjedhëse sipas madhësisë siç përcaktohet në metodën referencë për marrjen e kampioneve dhe matjen e PM-10, EN 12341, me efikasitet me kufi minimal 50 % në një diametër aerodinamik 10 μ m;
 - j. **“PM-2,5”** janë grimcat e materies që kalojnë nëpërmjet një hyrjeje përzgjedhëse sipas madhësisë siç përcaktohet në metodën referencë për marrjen e kampioneve dhe matjen e PM-2,5, EN 14907, me efikasitet me kufi minimal 50 % në një diametër aerodinamik 2,5 μ m;
 - k. **“Indikatori mesatar i ekspozimit”** është niveli mesatar i përcaktuar në bazë të matjeve në vende me karakter urban në të gjithë Republikën e Shqipërisë dhe që reflekton ekspozim të popullsisë. Ky indikator përdoret për të llogaritur synimin për pakësimin e ekspozimit kombëtar dhe detyrimin e përqendrimit të ekspozimit;
 - l. **“Detyrimi i përqendrimit të ekspozimit”** është niveli i fiksuar në bazë të indikatorit të ekspozimit mesatar me qëllim pakësimin e efekteve të dëmshme në shëndetin e njeriut, që duhet arritur gjatë një periudhe të dhënë;
 - m. **“Synimi i pakësimit të ekspozimit”** është pakësimi i përqindjes të ekspozimit mesatar të popullsisë së Republikës së Shqipërisë përcaktuar për vitin referencë me qëllim pakësimin e efekteve të

- dëmshme në shëndetin e njeriut, që duhet arritur gjatë një periudhe të dhënë, kur është e mundur;
- n. "**Vende me karakter urban**" janë vendet në zonat urbane ku nivelet janë përfaqësuese të ekspozimit të popullsisë urbane në përgjithësi;
 - o. "**Okside azoti**" janë shuma e raportit të përzierë të vëllimit (ppbv) të monoksidit të azotit (oksidi nitrik) dhe dikoksidi i azotit shprehur në njësi të përqendrimit të masës së dioksidit të azotit (μ g/m³);
 - p. "**Matje fikse**" janë matjet e kryera në territore të caktuara, ose në vazhdimësi ose nga marrja e kampioneve të rastësishme për të përcaktuar nivelet në përputhje me objektivat e cilësisë së të dhënave përkatëse;
 - q. "**Matje treguese**" janë matjet që plotësojnë objektivat e cilësisë së të dhënave që janë më pak strikte se ato që kërkohen për matjet e fiksuara;
 - r. "**Përbërje organike të paqendrueshme**" (VOC) janë përbërjet organike nga burimet antropogjenike dhe biogjenike, përveç metanit, që janë të afta të prodhojnë oksidantë fotokimikë nëpërmjet reaksioneve me oksidet e azotit në prani të dritës së diellit;
 - s. "**Substanca pararendëse të ozonit**" janë substancat që kontribuojnë në formimin e ozonit të nivelit bazë. Aneksi i këtij Vendimi përfshin listën jo-përfundimtare të këtyre substancave;
 - t. "**Ministër**" është Ministri përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit, dhe "**Ministria**" interpretohet në përputhje me këtë;
 - u. "**Arsenik, kadmium, nikel dhe benzo(a)piren**" është përmbajtja totale e këtyre elementëve dhe përbërjeve në fraksionin PM-10;
 - v. "**Hidrokarburet aromatike policiklike**" janë ato përbërje organike që përbëhen të paktën prej dy unazash aromatike të bashkëshkrira të formuara plotësisht nga karboni dhe hidrogjeni;
 - w. "**Mërkur i gaztë total**" është avulli elementar i mërkurit (Hg 0) dhe mërkuri reaktiv i gaztë, p.sh. llojet e mërkurit të tretshëm në ujë me trysni avulli mjaftueshëmrisht të lartë për të ekzistuar në fazën e gaztë.

III. Shpallja e agregatëve

3. Në përputhje me kërkesat e Nenit 5/1 (2) të Ligjit "Për Mbrojtjen nga Ndotja e Ajrit" Ministri e ndan vendin në agregatë.
4. Shpallja e agregatëve botohet në Fletoren Zyrtare.
5. Vlerësimi i cilësisë së ajrit dhe menaxhimi i cilësisë së ajrit kryhet në të gjithë agregatët.

Pjesa dy. Vlerësimi i cilësisë së ajrit të ambjentit

IV. Pragjet e vlerësimit

6. Ministri duhet të klasifikojë çdo agregat në përputhje, pavarësisht nëse pragjet e sipërme apo të poshtme të vlerësimit të specifikuara në Seksionin A të Aneksit II të këtij Vendimi tejkalohen ose jo, në lidhje me dioksidin e squfurit, dioksidin e azotit dhe oksidet e azotit, grimcat e materies, plumbin, benzenin dhe monoksidin e karbonit.
7. Ministri duhet të rishikojë klasifikimin e agregatëve të referuar në Paragrafin 6 të paktën çdo pesë vjet, dhe duhet të veprojë kështu më shpesh se pesë vjet në rast se ka ndryshime thelbësore në aktivitetet që mund të ndikojnë nivelet e dioksidit të squfurit, dioksidit të azotit dhe oksidit të azotit, grimcave të materies, plumbit, benzenit dhe monoksidit të karbonit në ajrin e ambjentit.
8. Gjatë rishikimit të agregatëve të referuar në Paragrafin 7 Ministri vepron në përputhje me procedurat e përcaktuara në Seksionin B të Aneksit II.

V. Kriteret e Vlerësimit

9. Ministri duhet të vlerësojë nivelin e dioksidit të squfurit, dioksidit të azotit dhe oksideve të azotit, grimcave të materies, plumbit, benzenit dhe monoksidit të karbonit në ajrin e ambjentit në të gjithë agregatët.
10. Tek të gjithë agregatët në rastet kur niveli i ndotësve të referuar në Paragrafin 9 tejkalon pragun e sipërm të vlerësimit të referuar në Paragrafin 6, duhen përdorur matjet fikse, por ato mund të plotësohen nga modelimi apo matjet treguese apo nga të dyja me qëllim që të sigurohet informacioni i duhur për shpërndarjen hapësinore të cilësisë së ajrit të ambjentit.
11. Tek të gjithë agregatët në rastet kur niveli i ndotësve të referuar në Paragrafin 9 tejkalon pragun e sipërm të vlerësimit të referuar në Paragrafin 6, mund të përdoret kombinimi i matjeve fikse dhe modelimi apo matjet treguese apo të dyja me qëllim që të sigurohet informacioni i duhur për shpërndarjen hapësinore të cilësisë së ajrit të ambjentit.
12. Tek të gjithë agregatët në rastet kur niveli i ndotësve të referuar në Paragrafin 9 është nën pragun e poshtëm të vlerësimit të referuar në Paragrafin 6, mund të përdoret modelimi apo teknikat e vlerësimit apo të dyja në vend të matjes.
13. Gjatë kryerjes së vlerësimeve të referuara në Paragrafët 9-12 duhen përdorur kriteret e përcaktuara në Aneksin III.
14. Përveç vlerësimeve të referuara në Paragrafët 9-12, Ministria duhet të matë PM_{2.5} në vendet me karakter rural larg nga burimet e rëndësishme të ndotjes së ajrit, me qëllim që të sigurohet informacion në baza mesatare vjetore për përqendrimin total të masës dhe përqendrimet e veçanta kimike të atij ndotësi.

15. Gjatë kryerjes së vlerësimit të referuar në Paragrafin 14, Ministria përdor kriteret e mëposhtme:
- a. Instalohet një pikë për marrjen e kampionëve për çdo 100 000 km²;
 - b. Ka të paktën një stacion matjeje që mbulon agregatët fqinjë (apo ekuivalentët) në Shtetet e tjera, për të arritur zgjidhjen e nevojshme hapësinore;
 - c. Seksionet A dhe C të Aneksit I zbatohen në lidhje me objektivat e cilësisë së të dhënave për matjen e përqendrimit të masës; dhe
 - d. Aneksi IV zbatohet plotësisht.

VI. Vendodhja dhe numrat e pikave të marrjes së kampionëve

16. Ministri instalon pikat për marrjen e kampionëve për vlerësimin e dioksidit të squfurit, dioksidit të azotit dhe oksideve të azotit, grimcave të materies, plumbit, benzenit dhe monoksidit të karbonit në vendet e përcaktuara në përputhje me kriteret e vendosura në Aneksin III.
17. Tek agregatët ku matja fikse është burimi i vetëm i informacionit për vlerësimin e cilësisë së ajrit, numri i pikave të marrjes së kampionëve duhet të jetë më i madh ose i barabartë me numrin minimal të specifikuar në Seksionin A të Aneksit V.
18. Tek agregatët e tjerë përveç atyre të referuar në Paragrafin 17, numri total i pikave të marrjes së kampionëve specifikuar në Seksionin A të Aneksit V mund të reduktohet deri në 50 %, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:
- a. metodat plotësuese ofrojnë informacion të mjaftueshëm për vlerësimin e cilësisë së ajrit përsa i përket vlerave kufi apo pragjeve alarm, si edhe informacionin e duhur për publikun;
 - b. numri i pikave të marrjes së kampionëve që do të instalohen dhe zgjidhja hapësinore e teknikave të tjera janë të mjaftueshme për përqendrimin e ndotësit përkatës që do të përcaktohet në përputhje me objektivat e cilësisë së të dhënave të specifikuara në Seksionin A të Aneksit I dhe do të mundësojë rezultatet e vlerësimit për të plotësuar kriteret e specifikuara në Seksionin B të Aneksit I.
19. Për qëllime të Paragrafit 18, rezultatet e modelimit dhe/ose matjet treguese merren në konsideratë për vlerësimin e cilësisë së ajrit për sa i përket vlerave kufi.

VII. Metodatat e matjes referencë

20. Subjekt i Paragrafit 21, për qëllime të këtij Vendimi përdoren metodatat e matjes referencë dhe kriteret e specifikuara në Seksionin A dhe Seksionin C të Aneksit VI.

21. Metodatat alternative për ato të specifikuara në Paragrafin 20 mund të përdoren me kusht që të plotësohen kushtet e përcaktuara në Seksionin B të Aneksit VI.

Pjesa tre. Ozoni

VIII. Kriteret e vlerësimit për ozonin

22. Ministri duhet të vlerësojë nivelin e ozonit tek të gjithë agregatët në rastet kur përqendrimet e ozonit kanë tejkaluar objektivat afatgjata të përcaktuara në Seksionin C të Aneksit VII gjatë secilit prej pesë vjeçarëve të mëparshëm të matjeve.
23. Në rastet kur janë të disponueshme të dhëna të më pak se pesë viteve, Ministri mund të kombinojë rezultatet nga fushatat e matjeve për kohëzgjatje të shkurtra të kryera në rastet kur dhe ku nivelet e ozonit kanë probabilitet të jenë më të lartat me rezultatet e përfutuara nga inventarët e shkarkimeve dhe modelimi, me qëllim që të përcaktohet nëse objektivat afatgjata të referuara në Paragrafin 22 janë tejkaluar gjatë këtyre pesë vjetëve.

IX. Pikat e marrjes së kampionëve për ozonin

24. Ministria instalon pika për marrjen e kampionëve për vlerësimin e ozonit në vendet e përcaktuara në përputhje me kriteret e përcaktuara në Aneksin VIII.
25. Në rastin e agregatëve ku matja fikse është burimi i vetëm i informacionit për vlerësimin e cilësisë së ajrit, numri i pikave për marrjen e kampionëve për matje fikse të ozonit nuk duhet të jetë më pak se numri minimal i specifikuar në Seksionin A të Aneksit IX.
26. Në rastin e agregatëve ku informacioni nga matja fikse plotësohet nëpërmjet informacionit të marrë nga modelimi ose matja fikse ose të dyja, numri i pikave të marrjes së kampionëve të referuar në Seksionin A të Aneksit IX mund të reduktohet me kusht që të plotësohen kushtet e ndryshme:
- a. metodatat plotësuese ofrojnë informacion të mjaftueshëm për vlerësimin e cilësisë së ajrit përsa i përket vlerave të synuara, objektivave afatgjata, informacionit dhe pragjeve alarm;
 - b. numri i pikave të marrjes së kampionëve që do të instalohen dhe zgjidhja hapësinore për teknika të tjera janë të mjaftueshme për përqendrimin e ozonit që do të përcaktohet në përputhje me objektivat për cilësinë e të dhënave specifikuar në Seksionin A të Aneksit I dhe bëjnë të mundur që rezultatet e vlerësimit të plotësojnë kriteret e specifikuara në Seksionin B të Aneksit I;
 - c. numri i pikave të marrjes së kampionëve në çdo agregat është të paktën një pikë për marrjen e kampionëve për dy milionë banorë ose një pikë për marrjen e kampionëve për 50 000 km², cilado prodhon numrin më të madh për pikat e marrjes së

kampionëve, por nuk duhet të jetë më pak se një pikë për marrjen e kampionëve për çdo agregat.

- d. dioksidi i azotit matet në të gjitha pikat e mbetura të marrjes së kampionëve me përjashtim të stacioneve me karakter rural siç referohen në Seksionin A të Aneksit VIII.

27. Për qëllime të Paragrafit 26, rezultatet e modelimit dhe/ose matja treguese merren në konsideratë për vlerësimin e cilësisë së ajrit përsa i përket vlerave të synyara.

28. Ministri duhet të sigurojë që dioksidi i azotit matet në jo më pak se 50% të pikave të marrjes së kampionëve të kërkuara në Seksionin A të Aneksit IX.

29. Matja e referuar në Paragrafin 28 duhet të jetë e vazhdueshme me përjashtim të vendeve me karakter rural.

30. Tek agregatët ku përqendrimet e ozonit kanë qenë nën objektivat afatgjata për secilën nga matjet e mëparshme pesë vjeçare, numri i pikave të marrjes së kampionëve duhet vendosur në përputhje me kriteret e përcaktuara në Seksionin B të Aneksit IX.

31. Ministri duhet të sigurojë që përqendrimet e substancave pararendëse të ozonit të listuara në Aneksin X maten të paktën në një pikë të marrjes së kampionëve.

32. Ministri mund të zgjedhë vendin dhe numrin e pikave të marrjes së kampionëve për matjen e substancave pararendëse të ozonit dhe duhet të marrë në konsideratë objektivat dhe metodat e përcaktuara në Aneksin X.

X. Metodatat e matjes referencë për ozonin

33. Në bazë të Paragrafit 34, zbatohet metoda referencë për matjen e ozonit përcaktuar në pikën 8 të Seksionit A të Aneksit VI.

34. Mund të përdoren metoda alternative për ato të specifikuar në Paragrafin 33 me kusht që të plotësohen kushtet e përcaktuara në Seksionin B të Aneksit VI.

Pjesa katër. Arseniku, kadmiumi, nikeli, mërkuri, benzo(a)pireni dhe hidrokarbure të tjera aromatike policiklike

XI. Pragjet e vlerësimit

35. Ministri duhet të klasifikojë çdo agregat përkatësisht pavarësisht nëse tejkalohen apo jo pragjet e sipërme apo të poshtme të vlerësimit të përcaktuara në Seksionin I të Aneksit XVII përsa i përket arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit.

36. Ministri duhet të rishikojë klasifikimin e agregatëve të referuar në Paragrafin 35 të paktën çdo pesë vjet, dhe duhet të veprojë në këtë mënyrë më shpesh se çdo pesë vjet nëse ka ndryshime thelbësore në aktivitetet që mund të ndikojnë nivelet e ndotësve të referuar në Paragrafin 35 në ajrin e ambjentit.

37. Gjatë rishikimit të agregatëve të referuar në Paragrafin 35 Ministri vepron në përputhje me procedurën e përcaktuar në Seksionin II të Aneksit XVII.

XII. Kriteret e vlerësimit

38. Ministri duhet të vlerësojë përqendrimet e arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit në ajrin e ambjentit.

39. Tek agregatët ku nivelet e arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit janë sipër pragjeve të poshtme të vlerësimit të përcaktuar në Seksionit I të Aneksit XVII, mund të përdoret kombinimi i matjeve fikse së bashku me matjet treguese siç referohet në Seksionin I të Aneksit XVIII ose modelimi, ose të dyja, për të vlerësuar nivelin e këtyre ndotësve në ajrin e ambjentit.

40. Tek agregatët ku nivelet e arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit janë nën pragjet e poshtme të vlerësimit të përcaktuar në Seksionit I të Aneksit XVII, mund të përdoret modelimi ose teknikat e vlerësimit objektiv në vend të matjeve.

XIII. Objektivat për cilësinë e të dhënave

41. Gjatë vlerësimit të niveleve të arsenikut, kadmiumit, nikelit, benzo(a)pirenit dhe hidrokarbureve të tjera aromatike policiklike dhe merkurit të gaztë, Ministri duhet të zbatojë objektivat për cilësinë e të dhënave dhe standarte të tjera të përcaktuara në Aneksin XVIII.

XIV. Vendi dhe numri i pikave të marrjes së kampionëve

42. Ministria përcakton vendin dhe numrin e marrjes së kampionëve për vlerësimin e arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit në përputhje me kriteret e përcaktuara në Aneksin XIX.

XV. Monitorimi i hidrokarbureve aromatike policiklike

43. Në mënyrë që të vlerësojë kontributin e benzo(a)pirenit në ajrin e ambjentit, Ministria monitoron hidrokarburet e tjera përkatëse aromatike policiklike në një numër të kufizuar territoresh monitorimi.

44. Përbërjet e referuara në Paragrafin 43 përfshijnë minimalisht;
a. benzo(a)antracenin,
b. benzo(b)fluorantenin,

- c. benzo(j)fluorantenin,
- d. benzo(k)fluorantenin,
- e. indeno(1,2,3-cd)pirenin,
- f. dibenz(a,h)antracenin.

45. Territoret e monitorimit të referuara në Paragrafin 43 duhen lokalizuar bashkë me territoret e marrjes së kampionëve të benzo(a)pirenit.
46. Territoret e monitorimit të referuara në Paragrafin 43 duhen përzgjedhur në mënyrë të tillë që të identifikohen ndryshimet gjeografike dhe tendencat afatgjata në përqendrimet e hidrokarbureve aromatike policiklike.
47. Territoret e monitorimit të referuara në Paragrafin 43 duhen përzgjedhur në përputhje me kriteret e seksioneve I deri në III të Aneksit XIX.

XVI. Monitorimi i sfondit / karakterit

48. Ministria duhet të operojë pika për marrjen e kampionëve të sfondit / karakterit për të siguruar matje treguese të:
- a. përqendrimeve të;
 - i. arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit;
 - ii. hidrokarbureve aromatike policiklike të referuara në Paragrafin 43;
 - iii. mërkurit të gaztë total.
 - b. evidenca totale të;
 - i. arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit Brenda fraksionit PM10;
 - ii. hidrokarbureve aromatike policiklike të referuara në Paragrafin 43;
 - iii. mërkurit.
49. Për qëllime të Paragrafit 48 Ministria duhet të sigurojë që:
- a. të paktën një pikë për marrjen e kampionëve instalohet për çdo 100,000 km²; dhe
 - b. çdo pikë për marrjen e kampionëve vendoset në përputhje me Aneksin XIX

XVII. Metodatat referencë për marrjen e kampionëve

50. Matjet e arsenikut, kadmiumit, mërkurit, nikelit dhe benzo(a)pirenit dhe and hidrokarbureve të tjera aromatike policiklike në ajrin e ambjentit dhe evidencat për këta ndotës duhen realizuar në përputhje me metodatat e matjes referencë të përcaktuara në Aneksin XX.

Pjesa pesë. Detyrimet në lidhje me vlerat kufi, vlerat e synuara, pragjet dhe nivelet

XVIII. Vlerat kufi

51. Ministri dhe njësitë e qeverisjes vendore duke vepruar brenda zonës së tyre përkatëse të kompetencave, sigurojnë që në të gjithë agregatët nivelet e dioksidit të squfurit, PM10, plumbi dhe monoksidi i karbonit në ajrin e ambjentit nuk tejkalojnë vlerat kufi të përcaktuara në Aneksin XI.
52. Ministria dhe njësitë e qeverisjes duke vepruar brenda zonës së tyre përkatëse të kompetencave, sigurojnë që në të gjithë agregatët nivelet e dioksidit të azotit dhe benzenit në ajrin e ambjentit nuk tejkalojnë vlerat kufi të përcaktuara në Aneksin XI nga datat e specifikuara në atë Aneks.
53. Respektimi i kërkesave të përcaktuara në Paragrafët 51 dhe 52 duhet të vlerësohet në përputhje me Aneksin III.
54. Për qëllime të Paragrafëve 51 dhe 52, zbatohen marzhet e tolerancës të përcaktuara në Aneksin XI.
55. Tek agregatët ku nivelet e dioksidit të squfurit, dioksidit të azotit, PM-10, PM-2,5, plumbi, benzeni dhe monoksidi i karbonit në ajrin e ambjentit janë nën vlerat përkatëse kufi të specifikuara në Aneksin XI dhe XIV, Ministria dhe njësitë e qeverisjes vendore, duke vepruar brenda zonës së tyre përkatëse të kompetencave, mbajnë nivelet e këtyre ndotësve nën vlerat kufi dhe bëjnë të gjitha përpjekjet për të ruajtur cilësinë më të mirë të ajrit të ambjentit, në harmoni me zhvillimin e qendrueshëm.

XIX. Vlerat e synuara

56. Ministria dhe njësitë e qeverisjes vendore, duke vepruar brenda zonës së tyre përkatëse të kompetencave, marrin të gjitha masat e nevojshme pa shkaktuar kosto jo-proporcionale për të siguruar që, që nga [31 Dhjetor 2012] përqendrimet e arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit, të përdorura si tregues për riskun karcinogjenik të hidrokarbureve aromatike policiklike, në ajrin e ambjentit, nuk tejkalojnë vlerat e synuara të përcaktuara në Aneksin XXI.
57. Ministria harton listën e agregatëve në të cilën nivelet e arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit janë nën vlerat e synuara përkatëse.
58. Ministria dhe njësitë e qeverisjes vendore, duke vepruar brenda zonës së tyre përkatëse të kompetencave, ruajnë nivelet e arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit në agregatët e referuar në Paragrafin 57 nën vlerat e synuara përkatëse dhe bëjnë të gjitha përpjekjet për të ruajtur cilësinë më të mirë të ajrit të ambjentit, në harmoni me zhvillimin e qendrueshëm.

59. Ministria harton listën e agregatëve në të cilën nivelet e arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit janë mbi vlerat e synuara përkatëse.
60. Për agregatët e referuar në Paragrafin 59, Ministri specifikon zonat e tejkallimit dhe burimet që kontribuojnë në to. Për këto zona Ministri demonstroi zbatimin e të gjitha masave të nevojshme pa shkaktuar kosto jo-proporcionale, drejtuar në veçanti tek burimet e shkarkimeve mbizotëruese, me qëllim që të arrihen vlerat e synuara përkatëse. Për instalimet industriale që kërkojnë leje mjedisi të Tipit A në përputhje me Ligjin "Për lejet e mjedisit" kjo nënkupton zbatimin e Teknikave më të Mira të Mundshme (TMM).

XX. Nivelet kritike për mbrojtjen e bimësisë

61. Ministria siguron respektimin e niveleve kritike për mbrojtjen e bimësisë të përcaktuar në Aneksin XIII, siç vlerësohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Seksionin A të Aneksit III.
62. Për qëllime të Paragrafit 61, ku matjet fikse janë burim i vetëm informacioni për vlerësimin e cilësisë së ajrit, numri i pikave për marrjen e kampionëve nuk duhet të jetë më i vogël se numri minimal i specifikuar në Seksionin C të Aneksit V.
63. Për qëllime të Paragrafit 61, ku matjet fikse plotësohen nga matje treguese ose modelimi, numri minimal i pikave të marrjes së kampionëve mund të reduktohet deri në 50 % për atë kohë sa përqendrimit e vlerësuara të ndotësve përkatës mund të përcaktohen në përputhje me objektivat për cilësinë e të dhënave të specifikuar në Seksionin A të Aneksit I.

XXI. Objektivat afatgjata për ozonin

64. Ministria dhe njësitë e qeverisjes vendore, duke vepruar brenda zonës së tyre përkatëse të kompetencave, marrin të gjitha masat e nevojshme pa shkaktuar kosto jo-proporcionale për të siguruar që arrihen vlerat e synuara dhe objektivat afatgjata për ozonin të përcaktuara në Aneksin VII.
65. Për agregatët tek të cilët tejkallohet vlera e synuar referuar në Paragrafin 64, Ministria dhe njësitë e qeverisjes vendore, duke vepruar brenda zonës së tyre përkatëse të kompetencave, sigurojnë që zbatohet programi përkatës dhe nëse është e përshtatshme plani i cilësisë së ajrit, me qëllim që të arrihet kjo vlerë e synuar, për atë sa kjo vlerë e synuar është e arritshme nëpërmjet masave që nuk shkaktajnë kosto jo-proporcionale.
66. Për agregatët në të cilët nivelet e ozonit në ajrin e ambjentit janë më të larta se sa objektivat afatgjata por më të ulëta se ose të barabarta me vlerat e synuara, Ministria dhe njësitë e qeverisjes vendore, duke

vepruar brenda zonës së tyre përkatëse të kompetencave, përgatisin dhe zbatojnë masa me kosto efektive me qëllim arritjen e këtyre objektivave afatgjata. Masa të tilla, të paktën, duhet të jenë në harmoni me programin dhe të gjitha planet për cilësinë e ajrit të referuara në Paragrafin 65.

67. Për agregatët në të cilët nivelet e ozonit plotësojnë objektivat afatgjata, Ministria dhe njësitë e qeverisjes vendore, duke vepruar brenda zonës së tyre përkatëse të kompetencave, për aq sa e lejojnë faktorët që përfshijnë natyrën ndërkufitare të ndotjes së ozonit dhe kushtet meteorologjike, ruajnë këto nivele nën objektivat afatgjata dhe marrin të gjitha masat e nevojshme proporcionale për të ruajtur cilësi më të mirë të ajrit të ambientit në harmoni me zhvillimin e qëndrueshëm dhe nivel të lartë të mbrojtjes mjedisore dhe shëndetit të njeriut.

XXII. Informacioni dhe pragjet alarm

68. Në rastet kur ndonjë nga pragjet e informacionit ose pragjet alarm të përcaktuara në Aneksin XII tejkalohe në lidhje me periudhat përkatëse mesatare të përcaktuara në këtë Aneks, Ministria duhet të informojë publikun nëpërmjet radios, televizionit, gazetave apo internetit.

XXIII. Kontributet nga burimet natyrore

69. Ministria mban listën e agregatëve, për çdo vit të dhënë, kur tejkalimet e vlerave kufi për çdo ndotës tek i cili zbatohet ky Vendim, i atribuohen burimeve natyrore.

70. Lista e referuar në Paragrafin 69 ofron informacion mbi përqendrimet dhe burimet dhe evidencat duke demonstruar që këto tejkalime i atribuohen burimeve natyrore.

71. Lista e referuar në Paragrafin 69 dhe informacioni i referuar në Paragrafin 70 botohen nga Ministria dhe vihen në dispozicion të publikut.

XXIV. Tejkalimet në sajë të hedhjes së rërës apo kripës në rrugë gjatë dimrit

72. Ministri mund të shpallë agregatët brenda të cilëve tejkalohe vlerat kufi për PM-10 në ajrin e ambientit për shkak të ri-lënies pezull të grimcave në vijimësit të hedhjes së rërës apo kripës në rrugë gjatë dimrit.

73. Ministria mban listën e agregatëve të shpallur në përputhje me Paragrafin 72.

74. Lista e referuar në Paragrafin 73 ofron informacion mbi përqendrimet dhe burimet e PM-10 aty, dhe evidencë të nevojshme për të demonstruar që të gjitha tejkalimet janë pasojë e grimcave të ri-lëna

pezull që të gjitha masat e arësyeshme janë marrë për të ulur përqendrimet.

75. Lista e referuar në Paragrafin 73 dhe informacioni i referuar në Paragrafin 74 botohen nga Ministria dhe vihen në dispozicion të publikut.

76. Pa paragjykuar Kreun XXIII, në rastin e agregatëve të referuar në Paragrafin 72, plani përkatës për cilësinë e ajrit nuk duhet lidhur me tejkalime të tilla.

Pjesa gjashtë. Pakësimi i Ekspozimit Kombëtar për PM-2,5

XXV. Treguesi i ekspozimit mesatar për PM-2,5

77. Ministria llogarit treguesin e ekspozimit mesatar për PM-2,5 për Republikën e Shqipërisë në përputhje me Seksionin A të Aneksit XIV.

78. Ministria siguron, në përputhje me Aneksin III, që shpërndarja dhe numri i pikavë të marrjes së kampionëve tek të cilat bazohet treguesi i ekspozimit mesatar për PM-2,5 reflekton siç duhet ekspozimin e popullsisë në përgjithësi.

79. Ministria siguron që numri i pikave të marrjes së kampionëve referuar në Paragrafin 78 nuk duhet të jetë më i vogël se ai që përcaktohet nga zbatimi i Seksionit B të Aneksit V.

XXVI. Synimi për pakësimin e ekspozimit kombëtar

80. Ministri përcakton synimin për pakësimin e ekspozimit kombëtar për Republikën e Shqipërisë në përputhje me Seksionin B të Aneksit XIV.

XXVII. Kufizimi i ekspozimit ndaj PM-2,5

81. Ministria dhe njësitë e qeverisjes vendore, duke vepruar brenda zonës së tyre përkatëse të kompetencave, marrin të gjitha masat e nevojshme pa shkaktuar kosto jo-proporcionale me qëllim arritjen e synimit të pakësimit të ekspozimit kombëtar deri në vitin 2020.

82. Ministria dhe njësitë e qeverisjes vendore, duke vepruar brenda zonës së tyre përkatëse të kompetencave, marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që treguesi i ekspozimit mesatar për PM-2,5 për vitin 2015 nuk tejkalon detyrimin për përqendrimin e ekspozimit të përcaktuar në Seksionin C të Aneksit XIV.

83. Ministria dhe njësitë e qeverisjes vendore, duke vepruar brenda zonës së tyre përkatëse të kompetencave, marrin të gjitha masat e nevojshme pa shkaktuar kosto jo-proporcionale, për të siguruar që përqendrimet e PM-2,5 në ajrin e ambjentit nuk tejkalojnë vlerën e

synuar të përcaktuar në Seksionin D të Aneksit XIV që nga data e specifikuar në atë Seksion.

84. Ministria dhe njësitë e qeverisjes vendore, duke vepruar brenda zonës së tyre përkatëse të kompetencave, marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që përqendrimet e PM-2,5 në ajrin e ambjentit nuk tejkalojnë vlerën kufi të përcaktuar në Seksionin E të Aneksit XIV në asnjë agregat që nga data e specifikuar në atë Seksion.

85. Ministria vlerëson respektimin e kërkesave të përcaktuara në Paragrafin 84 në përputhje me Aneksin III.

86. Marzhi i tolerancës i përcaktuar në Seksionin E të Aneksit XIV zbatohet për qëllime të planeve të cilësisë së ajrit.

Pjesa shtatë. Shtyrja e afateve për arritjen e vlerave kufi dhe përjashtimet nga zbatimi i vlerave kufi

XXVIII. Shtyrja e disa afateve

87. Në rastet kur, për ndonjë agregat të dhënë, vlerat kufi për dioksidin e azotit apo benzenin nuk mund të arrihen brenda afateve të specifikuara në Aneksin XI, Ministri mund t'i shtyjë afatet për atë agregat maksimumi me pesë vjet.

88. Në rastet kur afati shtyhet në përputhje me Paragrafin 87, përgatitet plani për cilësinë e ajrit për atë agregat, që duhet plotësuar me informacionin e listuar në Seksionin B të Aneksit XV në lidhje me ndotësit në fjalë dhe demonstroi mënyrën se si vlerat kufi duhen plotësuar deri në afatin e ri.

89. Në rastet kur zbatohet Paragrafi 87, Ministria dhe njësitë përkatëse të qeverisjes vendore, duke vepruar brenda zonave përkatëse të kompetencave, sigurojnë që vlera kufi për çdo ndotës nuk tejkalohej me më shumë se marzhi maksimal i tolerancës së specifikuar në Aneksin XI për secilin nga ndotësit në fjalë.

XXIX. Përjashtime nga zbatimi i vlerave kufi

90. Në rastet kur, për ndonjë agregat të dhënë, konformiteti me vlerat kufi për PM-10 të përcaktuara në Aneksin XI nuk mund të arrihen për shkak të karakteristikave të shpërhapjes specifike të territorit, nuk zbatohet detyrimi për të aplikuar këto vlera kufi deri më 11 Qershor 2011 [Data e direktivës].

91. Në rastet kur përjashtohet një vlerë kufi në përputhje me Paragrafin 90, përgatitet plani për cilësinë e ajrit për atë agregat, që duhet plotësuar me informacionin e listuar në Seksionin B të Aneksit XV në lidhje me ndotësit në fjalë dhe demonstroi mënyrën se si vlerat kufi duhen plotësuar deri në afatin e ri. Plani për cilësinë e ajrit tregon gjithashtu

që janë marrë të gjitha masat e përshtatshme në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal për të përmbushur këtë afat.

92. Në rastet kur zbatohet Paragrafi 90, Ministria dhe njësitë përkatëse të qeverisjes vendore, duke vepruar brenda zonave përkatëse të kompetencave, sigurojnë që vlera kufi për çdo ndotës nuk tejkalohet me më shumë se marzhi maksimal i tolerancës së specifikuar në Aneksin XI për secilin nga ndotësit në fjalë.

Pjesa tetë. Planet

XXX. Planet për cilësinë e ajrit

93. Ministria përgatit dhe zbaton planin për cilësinë e ajrit për çdo agregat në të cilin nivelet e dioksidit të squfurit, dioksidit të azotit, benzenit, monoksidit të karbonit, plumbit, grimcave të materies apo ozonit në ajrin e ambjentit tejkalojnë vlerat kufi apo vlerat e synuara të përcaktuara në Aneksin XI dhe XIV në lidhje me atë ndotës, duke marrë parasysh çdo marzh përkatës tolerance, pavarësisht nëse ka kaluar ose jo data e përmbushjes së vlerës kufi apo vlerës së synuar.
94. Në rastet kur ka kaluar data e përmbushjes për një vlerë kufi, plani për cilësinë e ajrit duhet të përcaktojë masat e synuara për të siguruar përmbushjen e vlerës kufi sa më parë të jetë e mundur.
95. Plani për cilësinë e ajrit përmban, të paktën informacionin e listuar në Seksionin A të Aneksit XV.
96. Plani për cilësinë e ajrit mund të përfshijë masa specifike të synuara për mbrojtjen e grupeve të ndjeshme përfshirë fëmijët.
97. Plani për cilësinë e ajrit mund të përfshijë masa në mbështetje të planeve afatshkurtra të veprimit.
98. Në rastet kur kërkohet një plan për cilësinë e ajrit në lidhje me më shumë se një ndotës, Ministria, kur duhet, përgatit dhe zbaton planin e integruar të cilësisë së ajrit në lidhje me të gjithë ndotësit përkatës.
99. Kurdo që është e mundur, planet e cilësisë për ajrin duhet të jenë konsistentë me planet e tjera të përgatitura që kanë lidhje me cilësinë e ajrit apo zhurmat mjedisore, me qëllim arritjen e objektivave përkatëse mjedisore.

XXXI. Planet Afatshkurtra të Veprimit

100. Në rastet kur, në ndonjë agregat, ekziston risku që nivelet e ndotësve të tejkalojnë një ose më shumë nga pragjet alarm të përcaktuara në Aneksin XII, Ministria duhet të përgatisë dhe zbatojë planin afatshkurtër të veprimit.

101. Plani afatshkurtër i veprimit duhet të përcaktojë masat që do të merren në periudhën afatshkurtër me synimin për të pakësuar riskun e tejkalimit të pragjeve alarm apo në rast të tejkalimit të kufijve, për të pakësuar kohëzgjatjen e një incidenti tillë.
102. Në rastet kur, në ndonjë agregat, nivelet e ozonit tejkalojnë pragun alarm të përcaktuar në Seksionin B të Aneksit XII apo ekziston risku që ato të tejkalojnë atë prag, Ministria përgatit dhe zbaton një plan veprimi afatshkurtër, kur sipas gjykimit të tyre ka potencial të konsiderueshëm, duke marrë parasysh kushtet gjeografike, meteorologjike dhe ekonomike për të pakësuar riskun, kohëzgjatjen apo seriozitetin e një situatë të tillë.
103. Ministria mund të përgatisë gjithashtu, kur duhet, planet afatshkurtra të veprimit kur ekziston risku që të tejkalohet një ose më shumë prej vlerave kufi apo vlerave të synuara të përcaktuara në Aneksin VII, XI dhe XIV.
104. Planet afatshkurtra të veprimit të referuara në Paragrafët 100, 101, 102 ose 103 mund, në varësi të rastit individual, përcaktojnë masat efektive për të kontrolluar dhe, kur është e nevojshme, pezullojnë aktivitetet që kontribuojnë në riskun e tejkalimit të vlerave përkatëse kufi apo vlerave të synuara apo pragut alarm. Këto plane veprimi mund të përfshijnë masa në lidhje me trafikun e automjeteve, punimet në ndërtim, anijet në vendet e ankorimit, dhe përdorimin e impianteve industriale apo produkteve dhe ngrohjes së shtëpive. Veprime specifike që synojnë mbrojtjen e grupeve të ndjeshme të popullsisë, përfshirë fëmijët, mund të merren në konsideratë në kuadër të këtyre planeve.

XXXII. Pjesëmarrja publike në përgatitjen e Planeve për Cilësinë e Ajrit dhe Planet Afatshkurtra të Veprimit

105. Ministria duhet të konsultohet me publikun në rastet kur Ministria propozon të përgatisë, modifikojë apo rishikojë Planin për Cilësinë e Ajrit apo Planin Afatshkurtër të Veprimit.
106. Në rastet kur gjen zbatim Paragrafi 105, Ministria:
- a. Informon publikun për propozimin dhe çdo informacion përkatës për mjedisin;
 - b. Informon publikun për të drejtat e publikut për pjesëmarrje në përgatitjen e planit;
 - c. Specifikon metodat nëpërmjet të cilave publiku mund të marrë pjesë në konsultim;
 - d. Specifikon kohën e arsyeshme për konsultim;
 - e. Specifikon adresën tek e cila dërgohen komentet.
107. Ministria merr parasysh rezultatet e konsultimit të referuar në Paragrafin 106 gjatë përgatitjes së planit.

108. Kur publikohet plani, Ministria gjithashtu i ofron informacion publikut për sa i përket arsyeve për përmbajtjen e planit si edhe informacion për procesin që është kryer për pjesëmarrjen e publikut.

XXXIII. Informimi publik

109. Ministria vë në dispozicion të publikut dhe organizatave të tjera të interesuara për sa më poshtë:

- a. Cilësinë e ajrit të ambientit në përputhje me Annex XVI;
- b. Informacion për çdo shtyrje afati për përmbushjen e vlerave kufi për dioksidin e azotit apo benzenin, në përputhje me Paragrafin 87;
- c. Informacion për çdo përjashtim për afatet për përmbushjen e vlerave kufi për PM-10, në përputhje me Paragrafin 90;
- d. Çdo plan për cilësinë e ajrit;
- e. Çdo plan veprimi afatshkurtër.

110. Informacioni i referuar në Paragrafin 109 duhet të jetë:

- a. I mjaftueshëm;
- b. I vënë në dispozicion në kohë të përshtatshme;
- c. I disponueshëm falas nëpërmjet çdo lloj mjeti komunikimi lehtësisht të aksesueshëm, përfshirë internetin apo çdo lloj tjetër mjeti të përshtatshëm telekomunikimi.

111. Për qëllime të Paragrafit 109, 'organizatat e interesuara' përfshijnë, në veçanti:

- a. Organizata mjedisore;
- b. Organizata që përfaqësojnë interesat e popullsisë së ndjeshme;
- c. Trupa të tjerë përkatës në lidhje me kujdesin shëndetësor, dhe
- d. Federatat industriale përkatëse.

XXXIV. Raportet vjetore

112. Ministria publikon dhe vë në dispozicion të publikut raportet vjetore për të gjithë ndotësit të trajtuar në këtë Vendim.

113. Raportet vjetore duhet të përfshijnë, për periudhën përkatëse mesatare:

- a. Detaje për të gjitha rastet ku nivelet e ndotësve kanë tejkalluar vlerat kufi;
- b. Detaje për të gjitha rastet ku nivelet e ndotësve kanë tejkalluar vlerat e synuara;
- c. Detaje për të gjitha rastet ku nivelet e ndotësve kanë tejkalluar objektivat afatgjata;
- d. Detaje për të gjitha rastet ku nivelet e ndotësve kanë tejkalluar pragjet e informacionit;
- e. Detaje për të gjitha rastet ku nivelet e ndotësve kanë tejkalluar pragjet alarm;
- f. Vlerësim përmbledhës për efektet e rasteve të referuara nga (a) deri në (e).

114. Raportet vjetore mund të përfshijnë gjithashtu, kur duhet, informacion i mëtejshëm dhe vlerësime për mbrojtjen e pyjeve, si edhe informacion për ndotësit e tjerë për të cilët dispozitat për monitorimin janë përcaktuar në këtë Vendim, përfshirë substancat pararendëse të ozonit të listuara në Seksionin B të Aneksit X.

XXXV.Ndotja ndërkufitare e ajrit

115. Në rastet kur tejkalohej ndonjë prag alarm, vlerë kufi apo vlerë e synuar së bashku me çdo marzh përkatës tolerance apo objektiv afatgjatë për shkak të transportit të konsiderueshëm ndërkufitar të ndotësve të ajrit apo pararendësve të tyre, Ministria bën të gjitha përpjekjet për të bashkëpunuar me secilin prej Shteteve fqinjë të përfshira, dhe ku është e përshtatshme, përgatit aktivitete të përbashkëta, përfshirë përgatitjen e planeve të përbashkëta apo të koordinuara për cilësinë e ajrit.

116. Ministri mund të drejtojë Ministrinë, nëse është e përshtatshme, për të përgatitur dhe zbatuar plani të përbashkëta veprimi afatshkurtër që trajtojnë agregatët fqinjë në Shtetet e tjera.

117. Ministri siguron që çdo agregat fqinj në një Shtet tjetër që ka përgatitur plane veprimi afatshkurtër të marrë gjithë informacionin e duhur.

118. Në rastet kur tejkalohej pragjet e informacionit apo pragjet alarm në agregatë në afërsi të kufijve të Republikës së Shqipërisë, Ministri i ofron informacion të menjëhershëm autoriteteve të duhura në Shtetin përkatës fqinj.

Aneksi I. Objektivat për cilësinë e të dhënave

Seksioni A. Objektivat për cilësinë e të dhënave për vlerësimin e cilësisë së ajrit të ambjentit

	Dioksidi i sulfurit, dioksidi i azotit dhe oksidet e azotit dhe monoksisidi i karbonit	Benzeni	Grimcat e materies (PM-10/PM-2,5) dhe plumbi	Ozoni dhe NO dhe NO2 përkatës
Matja fikse (1)				
Pasiguria	15%	25%	25%	15%
Marrja e të dhënave minimale	90%	90%	90%	90% në verë 75% në dimër
Mbulimi kohor minimal:				
- karakteri urban dhe trafiku	--	35% (2)	--	--
- zonat industriale	--	90%	--	--
Matjet treguese				
Pasiguria	25%	30%	50%	30%
Marrja e të dhënave minimale	90%	90%	90%	90%
Mbulimi kohor minimal:	14% (4)	14% (3)	14% (4)	Më shumë se 10% në verë
Pasiguria e modelimit				
Për orë	50%	--	--	50%
Mesataret tetë-orëshe	50%	--	--	50%
Mesataret ditore	50%	--	--	--
Mesataret vjetore	30%	50%	50%	--
Pasiguria e vlerësimit të objektivit	75%	100%	100%	75%

Shënime për Tabelën

- (1) Ministria mund të zbatojë masa të rastësishme në vend të masave të vazhdueshme për benzenin, plumbin dhe grimcat e materies nëse ata mund t'i demonstrojnë Ministrin që pasiguria, përfshirë pasigurinë për shkak të marrjes së rastësishme të kampionëve, plotëson objektivin e cilësisë prej 25 % dhe mbulimi kohor është ende më i madh se mbulimi kohor minimal për matjet treguese. Marrja e rastësishme e kampionëve duhet të shpërndahet njëtrajtësisht gjatë vitit me qëllim që të shmangët shtrembërimi i rezultateve. Pasiguria për shkak të marrjes së rastësishme të kampionëve mund të përcaktohet nga procedura përcaktuar në ISO 11222 (2002) 'Cilësia e Ajrit — Përcaktimi i Pasigurisë së Kohës Mesatare në lidhje me Masat për Cilësinë e Ajrit'. Nëse

masat e rastësishme përdoren për të vlerësuar kërkesat e vlerës kufi PM10, niveli në përqindje prej 90,4 (të jetë më i vogël se ose i barabartë me 50 µg/m³) duhet vlerësuar në vend të numrit të tejkalimeve, që influencohet shumë nga mbulimi i të dhënave.

- (2) Të shpërndara gjatë vitit për të qenë përfaqësuese të kushteve të ndryshme për klimën dhe trafikun.
 - (3) Matje një ditë në javë në mënyrë rastësore, të shpërndara njëtrajtësisht gjatë vitit, ose tetë javë të shpërndara njëtrajtësisht gjatë vitit.
 - (4) Një matje në javë në mënyrë rastësore, të shpërndara njëtrajtësisht gjatë vitit, ose tetë javë të shpërndara njëtrajtësisht gjatë vitit.
1. Pasiguria (shprehur në nivel confidence 95 %) e metodave të vlerësimit do të vlerësohet në përputhje me parimet e Guidës CEN për Shprehjen e Pasigurisë në Matje (ENV 13005-1999), metodologjinë e ISO 5725:1994 dhe udhërrëfyesin e ofruar në raportin CEN 'Cilësia e Ajrit — Përqasja për Vlerësimin e Pasigurisë për Metodën e Matjes Referencë për Ajrin e Ambjentit' (CR 14377:2002E). Përqindjet për pasigurinë në tabelën e mësipërme jepen për matjet individuale të mesatarizuara gjatë periudhës të konsideruar nga vlera kufi (apo vlera e synuar në rastin e ozonit), për intervalin e konfidencës 95 %. Pasiguria për matjet fikse interpretohet si është e aplikueshme në rajonin e vlerës së duhur kufi (apo vlerës së synuar në rastin e ozonit).
 2. Pasiguria për modelimin përcaktohet si shmangia maksimale e niveleve të përqendrimit të matur dhe llogaritur për 90 % të pikave individuale të monitorimit, gjatë periudhave të konsideruara, prej vlerës kufi (apo vlerës së synuar në rastin e ozonit), pa marrë parasysh kohën e ngjarjeve. Pasiguria për modelimin interpretohet si është e aplikueshme në rajonin e vlerës së duhur kufi (apo vlerës së synuar në rastin e ozonit). Matjet fikse që duhen përzgjedhur për krahasim me rezultatet e modelimit duhet të jenë përfaqësuese të shkallës së mbuluar nga modeli.
 3. Pasiguria për vlerësimin objektiv përcaktohet si shmangia maksimale e niveleve të përqendrimit të matur dhe llogaritur, gjatë periudhave të konsideruara, prej vlerës kufi (apo vlerës së synuar në rastin e ozonit), pa marrë parasysh kohën e ngjarjeve.
 4. Kërkesat për marrjen e të dhënave minimale dhe mbulimi kohor nuk përfshin humbjet e të dhënave për shkak të kalibrimit të rregullt apo mirëmbajtjes normale të përdorimit të instrumentave.

Seksioni B. Rezultatet e vlerësimit për cilësinë e ajrit

1. Informacioni i mëposhtëm hartohet për agregatët brenda të cilëve përveç matjeve përdoren burime për të plotësuar informacionin nga matjet ose si mjete të vetme për vlerësimin e cilësisë së ajrit:

- a. përshkrim për aktivitetet e vlerësimit që janë kryer,
- b. metodat specifike që janë përdorur, me referenca për përshkrimet e metodës,
- c. burimet e datës dhe informacionit,
- d. përshkrim i rezultateve, përfshirë pasiguritë dhe, në veçanti, shtrirjen e çdo zone, dhe nëse ka lidhje, gjatësinë e rrugës brenda agregatit tek i cili përqendrimet tejkalojnë ndonjë nga vlerat kufi, vlerat e synuara apo objektivat afatgjata plus marzhin e tolerancës, nëse është i aplikueshëm, dhe të çdo zone brenda së cilës përqendrimet tejkalojnë pragun e sipërm të vlerësimit apo pragun e poshtëm të vlerësimit,
- e. popullsia potencialisht e ekspozuar ndaj niveleve që tejkalojnë ndonjë nga vlerat kufi për mbrojtjen e shëndetit të njeriut.

Seksioni C. Sigurimi i cilësisë për cilësinë e ajrit të ambjentit: miratimi i të dhënave (bërja e vlefshme e të dhënave)

1. Për të siguruar saktësinë e matjeve dhe respektimin e objektivave për cilësinë e të dhënave të përcaktuara në Seksionin A, Ministria dhe njësitë e qeverisjes vendore garantojnë për sa më poshtë:
 - a. që të gjitha matjet e ndërmarra në lidhje me vlerësimin e cilësisë së ajrit të ambjentit në bazë të Seksioneve V dhe VII janë të gjurmueshme në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Seksionin 5.6.2.2 të ISO/IEC 17025:2005,
 - b. që institucionet që operojnë rrjete dhe stacione individuale kanë të ngritur një sigurim cilësie dhe një sistem për kontrollin e cilësisë që kërkon mirëmbajtje të rregullt për të garantuar saktësinë e mjeteve matëse,
 - c. që një process për kontrollin e cilësisë/sigurimin e cilësisë është krijuar për procesin e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave dhe që institucionet e caktuara për këtë detyrë marrin pjesë aktivisht në programet përkatëse mbarë Komunitare për sigurimin e cilësisë,
 - d. që laboratorët kombëtarë janë akredituar për EN/ISO 17025 deri në vitin 2010 për metodat referencë të referuara në Aneksin VI. Këto laboratorë koordinojnë, në nivel kombëtar, realizimin e duhur të metodave referencë dhe demonstrimin e ekuivalencës për metodat jo-referencë.
2. Të gjitha të dhënat për cilësinë e ajrit të ambjentit të raportuara nën Paragrafët 109 dhe 112 konsiderohen të vlefshëm me përjashtim të të dhënave të shenjuara me flamur si të përkohshme.

Aneksi II. Përcaktimi i kërkesave për vlerësimin e përqendrimeve të dioksidit të sqfurit, dioksidit të azotit dhe oksideve të azotit, grimcave të materies (PM10 dhe PM2,5), plumbit, benzenit dhe monoksidit të karbonit në ajrin e ambjentit brenda një agregati

Seksioni A. Pragjet e sipërme dhe të poshtme të vlerësimit

Do të zbatohen pragjet e sipërme dhe të poshtme të vlerësimit:

1. Dioksidi i sqfurit

	Mbrojtja e shëndetit	Mbrojtja e bimësisë
Pragu i sipërm i vlerësimit	60 % e vlerës kufi 24-orëshe (75 µg/m ³ , të mos tejkalohet më shumë se sa 3 herë në një vit kalendarik)	60 % e nivelit kritik të dimrit (12 µg/m ³)
Pragu i poshtëm i vlerësimit	40 % e vlerës kufi 24-orëshe (50 µg/m ³ , të mos tejkalohet më shumë se sa 3 herë në një vit kalendarik)	40 % e nivelit kritik të dimrit (8 µg/m ³)

2. Dioksidi i azotit dhe oksidet e azotit

	Vlera kufi për orë për mbrojtjen e shëndetit të njeriut (NO ₂)	Vlera kufi vjetore për mbrojtjen e shëndetit të njeriut (NO ₂)	Niveli vjetor kritik për mbrojtjen e bimësisë dhe ekosistemet natyrore (NO _x)
Pragu i sipërm i vlerësimit	70 % e vlerës kufi (140 µg/m ³ , të mos tejkalohet më shumë se sa 18 herë në një vit kalendarik)	80 % e vlerës kufi (32 µg/m ³)	80 % e nivelit kritik (24 µg/m ³)
Pragu i poshtëm i vlerësimit	50 % e vlerës kufi (100 µg/m ³ , të mos tejkalohet më shumë se sa 18 herë në një vit kalendarik)	65 % e vlerës kufi (26 µg/m ³)	65 % e nivelit kritik (19,5 µg/m ³)

3. Grimcat e materies (PM-10/PM-2,5)

	Mesatarja 24-orëshe PM10	Mesatarja vjetore PM10	Mesatarja vjetore PM2,5 (1)
Pragu i sipërm i vlerësimit	70 % e vlerës kufi (35 µg/m ³ , të mos tejkalohet më shumë se sa 35 herë në një vit kalendarik)	70 % e vlerës kufi (28 µg/m ³)	70 % of limit value (17 µg/m ³)
Pragu i poshtëm i vlerësimit	50 % e vlerës kufi (25 µg/m ³ , të mos tejkalohet më shumë se sa 35 herë në një vit kalendarik)	50 % e vlerës kufi (20 µg/m ³)	50 % e vlerës kufi (12 µg/m ³)

(1) Pragu i sipërm i vlerësimit dhe pragu i poshtëm i vlerësimit për PM_{2,5} nuk zbatohen për masat për vlerësimin e përmbushjes së synimit për pakësimin e ekspozimit PM_{2,5} për mbrojtjen e shëndetit të njeriut.

4. Plumbi

	Mesatarja vjetore
Pragu i sipërm i vlerësimit	70 % e vlerës kufi (0,35 µg/m ³)
Pragu i poshtëm i vlerësimit	50 % e vlerës kufi (0,25 µg/m ³)

5. Benzeni

	Mesatarja vjetore
Pragu i sipërm i vlerësimit	70 % e vlerës kufi (3,5 µg/m ³)
Pragu i poshtëm i vlerësimit	40 % e vlerës kufi (2 µg/m ³)

6. Monoksidi i karbonit

	Mesatarja e tetë orëve
Pragu i sipërm i vlerësimit	70 % e vlerës kufi (7 mg/m ³)
Pragu i poshtëm i vlerësimit	50 % e vlerës kufi (5 mg/m ³)

Seksioni B. Përcaktimi i tejkalimeve të pragjeve të sipërme dhe të poshtme të vlerësimit

1. Tejkalimet e pragjeve të sipërme dhe të poshtme të vlerësimit përcaktohen në bazë të përqendrimeve gjatë pesë vjeçarëve të mëparshëm kur janë të disponueshme të dhëna të mjaftueshme. Pragu i vlerësimit konsiderohet si i tejkaluar nëse ai është tejkaluar gjatë të paktën tre viteve nga pesë vitet e mëparshme.
2. Kur ka të dhëna të disponueshme më pak se pesë vjeçare, Ministria mund të kombinojë fushata matjesh me kohëzgjatje të shkurtër gjatë harkut kohor vjetor dhe në vende që kanë gjasa të jenë tipike për nivelet më të lartë të ndotjes me rezultatet e përfuara nga informacioni nga inventarët e shkarkimit dhe modelimi për të përcaktuar tejkalimet e pragjeve të sipërme dhe të poshtme të vlerësimit.

ANEKSI III. Vlerësimi i cilësisë së ajrit të ambjentit dhe vendodhja e pikave të marrjes së kampionëve për matjet e dioksidit të squfurit, dioksidit të azotit dhe oksideve të azotit, grimcave të materies (PM10 dhe PM2,5), plumbit, benzenit dhe monoksidit të karbonit në ajrin e ambjentit

Seksioni A. Të përgjithshme

Cilësia e ajrit të ambjentit vlerësohet në të gjithë agregatët në përputhje me kriteret e mëposhtme:

1. Cilësia e ajrit të ambjentit vlerësohet në të gjitha vendet me përjashtim të atyre të listuara në paragrafin 2, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Seksionet B dhe C për vendin e marrjes së kampionëve për matjet fikse. Parimet e përcaktuara nga Seksionet B dhe C zbatohen për aq kohë sa kanë lidhje me identifikimin e vendeve specifike tek të cilat janë krijuar përqendrime të ndotësve përkatës kur cilësia e ajrit të ambjentit është vlerësuar me matje treguese ose modelim.
2. Përmbushja e vlerave kufi drejtuar mbrojtjes së shëndetit të njeriut nuk vlerësohet në vendet e mëposhtme:
 - a. çdo vend që ndodhet brenda zonave ku anëtarët e publikut nuk kanë akses dhe nuk ka vendbanime fikse;
 - b. në përputhje me përkufizimin e 'ajrit të ambjentit', në vendet e fabrikave apo instalimeve industriale tek të cilat gjejnë zbatim të gjitha dispozitat përkatëse në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë;
 - c. në rrugët e transportit; dhe në vendet e rezervuara qendrore të rrugëve ku normalisht këmbësorët kanë akses për në këto vende të rezervuara qendrore.

Seksioni B. Përcaktimi i territorit të pikave për marrjen e kampionëve në shkallë makro

1. Mbrojtja e shëndetit të njeriut
 - a. Pikat për marrjen e kampionëve të drejtuara tek mbrojtja e shëndetit të njeriut duhen përcaktuar në vende të tilla që të sigurohen të dhëna për sa më poshtë:
 - i. zonat brenda agregatëve ku ndodhin përqendrimet më të larta ndaj të cilave popullsia ka gjasa të jetë e ekspozuar drejtpërsëdrejti apo indirekt për një periudhë kohore të konsiderueshme në lidhje me periudhën mesatare të vlerës(ave) kufi,
 - ii. nivelet në zonat e tjera brenda agregatëve që janë përfaqësues të ekspozimit të popullsisë në përgjithësi,
 - b. Pikat për marrjen e kampionëve në përgjithësi duhen përcaktuar në mënyrë të tillë që të shmanget matja e mikro-mjediseve shumë të vogla në afërsi direkte të tyre, që do të thotë që një pikë për marrjen e kampionëve duhet përcaktuar në mënyrë të tillë që ajri i marrë si kampionë është përfaqësues i cilësisë së ajrit për një segment ruge jo më pak se 100 m të gjatë në zona me trafik dhe

të paktën 250 m × 250 m në zonat industriale, ku është e mundur nga ana praktike;

- c. Vendet me karakter urban lokalizohen në mënyrë të tillë që niveli i ndotjes influencohet nga kontributi i integruar nga të gjitha burimet kundra erës së stacionit. Niveli i ndotjes nuk duhet të dominohet nga një burim i vetëm në qoftë se një situatë e tillë është tipike për një zonë më të madhe urbane. Këto pika për marrjen e kampionëve, si rregull i përgjithshëm, duhet të jenë përfaqësues për disa kilometra katrorë;
- d. Në rastet kur objektivi është vlerësimi i niveleve me karakter rural, pika për marrjen e kampionëve nuk duhet të influencohet nga aglomeratët apo zonat industriale në afërsi të saj, që do të thotë zona më afër se pesë kilometra;
- e. Në rastet kur do të vlerësohen kontributet nga zonat industriale, të paktën një pikë për marrjen e kampionëve do të instalohen në drejtimin e erës në zonën më të afërt të banimit. Në rastet kur përqëndrimi i karakterit nuk dihet, përqëndrimi i rrumbullakosur nuk dihet, një pikë shtesë për marrjen e kampionëve do të vendoset brenda drejtimit kryesor të erës;
- f. Pikat për marrjen e kampionëve, kur është e mundur, do të jenë gjithashtu përfaqësuese të vendeve të njëjta jo në afërsinë direkte të tyre;
- g. Duhet marrë parasysh nevoja për të lokalizuar pikat e marrjes së kampionëve në ishuj kur është e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit të njeriut.

2. Mbrojtja e bimësisë dhe ekosistemeve natyrore

- a. Pikat e marrjes së kampionëve të synuara për mbrojtjen e bimësisë dhe ekosistemeve natyrore duhet të vendosen më shumë se 20 km larg agregatëve ose më shumë se 5 km larg zonave të tjera të urbanizuara, instalimeve industriale apo rrugëve automobilistike ose rrugëve kryesore me trafik të llogaritur prej më shumë se 50 000 automjete në ditë, që do të thotë se një pikë për marrjen e kampionëve duhet të pozicionohet në mënyrë të tillë që ajri i marrë si kampion të jetë përfaqësues i cilësisë së ajrit në mjedisin rrethues prej të paktën 1 000 km². Ministri mund të mbështesë që një pikë për marrjen e kampionëve të pozicionohet në një distancë më të vogël apo të jetë përfaqësuese e cilësisë së ajrit në një zonë me shtrirje më të vogël, duke marrë parasysh kushtet gjeografike apo mundësitë për të mbrojtur veçanërisht zonat në rrezik.
- b. Duhet marrë parasysh nevoja për të vlerësuar cilësinë e ajrit në ishuj.

Seksioni C. Përcaktimi i territorit të pikave për marrjen e kampionëve në shkallë mikro

1. Për aq sa është e praktikueshme, zbatohet sa më poshtë:
 - a. rrjedha përreth hyrjes së sondës për marrjen e kampionëve është e pakufizuar (e lirë në një hark prej të paktën 270°) nga pengesa që ndikojnë rrjedhën e ajrit në afërsi të shabllonit (normalisht disa metra larg godinave, ballkonëve dhe pengesave të tjera dhe të paktën 0,5 m nga ndërtesa më e afërt në rastin e pikave të marrjes së kampionëve që përfaqësojnë cilësinë e ajrit në vijën e ndërtesës),
 - b. në përgjithësi, pika hyrëse e marrjes së kampionëve është midis 1,5 m (zona e frymëmarrjes) dhe 4 m mbi tokë. Pozicionet më të larta (deri në 8 m) mund të jenë të nevojshme në disa raste. Përcaktim i territorit më të lartë mund të jetë gjithashtu i përshtatshëm nëse stacioni është përfaqësues i një zone të madhe,
 - c. sonda hyrëse nuk pozicionohet në afërsi direkte me burimet me qëllim që të shmanget futja direkte e shkarkimeve të papërziera me ajrin e ambjentit,
 - d. dalja e shkarkimit të shabllonit pozicionohet në mënyrë të tillë që të shmanget riqarkullimi i ajrit të shkarkuar në hyrjen e shabllonit,
 - e. për të gjithë ndotësit, sondat e marrjes së kampionëve të orientuara nga trafiku janë të paktën 25 m nga buza e kryqëzimeve të mëdha dhe jo më shumë se 10 m nga cepi i trotuarit.
2. Faktorët e mëposhtëm mund të merren gjithashtu parasysh:
 - a. burimet interferuese,
 - b. sigurimi,
 - c. aksesit,
 - d. disponueshmëria e energjisë elektrike dhe komunikimeve telefonike,
 - e. vizibiliteti i territorit në lidhje me zonat përreth tij,
 - f. siguria e publikut dhe operatorëve,
 - g. dëshirueshmëria e bashkë-lokalizimit të pikave për marrjen e kampionëve për ndotës të ndryshëm,
 - h. kërkesat për planifikim.

Seksioni D. Dokumentacioni dhe rishikimi i përzgjedhjes së territorit

1. Proçedurat për përzgjedhjen e territorit duhet të dokumentohen plotësisht në fazën e klasifikimit me mjete të tilla si fotografitë e gjithë perimetrit të zonës rrethuese dhe harta e detajuar. Territoret rishikohen në interval të rregullta me dokumentacion të përsëritur për të siguruar që kriteret e përzgjedhjes mbeten të vlefshme me kalimin e kohës.

ANEKSI IV. MATJET NË VENDET ME KARAKTER RURAL PAVËRËSISHT NGA PËRQËNDRIMI

Seksioni A. Objektivat

1. Objektivat kryesore të këtyre matjeve janë të sigurojnë që informacioni i duhur është i disponueshëm në nivelet në mjedis. Ky informacion është thelbësor për të gjykuar nivelet e shtuara në zonat më shumë të ndotura (si mjedisi urban, vendet e lidhura me industrinë, vendet e lidhura me trafikun), për të vlerësuar kontributin e mundshëm nga transporti me rreze të gjatë veprimi i ndotësve të ajrit, për të mbështetur analizën e shpërndarjes së burimit dhe për të kuptuar ndotësit specifikë siç janë grimcat e materies. Gjithashtu, është thelbësor për përdorimin e rritur të modelimit në zonat urbane.

Seksioni B. Substancat

1. Matja e PM_{2,5} duhet të përfshijë të paktën përqendrimin e masës totale dhe përqendrimet e përbërjeve të përshtatshme për të karakterizuar përbërjen e vet kimike. Duhet përfshirë të paktën lista e llojeve të kimikateve të dhëna më poshtë:
 - a. SO₄²⁻
 - b. Na⁺
 - c. NH₄⁺
 - d. Ca²⁺
 - e. NO₃⁻
 - f. K⁺
 - g. Cl⁻
 - h. Mg²⁺
 - i. Karboni elementar (EC)
 - j. Karboni organik (OC).

Seksioni C. Përcaktimi i territorit

1. Matjet duhen kryer në përputhje me Seksionet A, B, dhe C të Aneksit III, veçanërisht në zonat me karakter rural.

ANEKSI V. Kriteret për përcaktimin e numrave minimalë të pikave për marrjen e kampionëve për matjen fikse të përqendrimeve të dioksidit të squfurit, dioksidit të azotit dhe oksideve të azotit, grimcave të materies (PM10, PM2,5), plumbit, benzenit dhe monoksidit të karbonit në ajrin e ambjentit

A. Numri minimal i pikave për marrjen e kampionëve për matje fikse për të vlerësuar respektimin e vlerave kufi për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe pragjet alarm në zonat dhe aglomeratët në të cilat matja fikse është burimi i vetëm i informacionit

1. Burimet e shpërndarjes

Popullsia agregatit (mijë)	Nëse përqendrimet maksimale tejkalojnë prapun e sipërm të vlerësimit (1)		Nëse përqendrimet maksimale janë midis pragjeve të sipërme dhe të poshtme të vlerësimit	
	Ndotësit përveç PM	PM (2) (shuma e PM10 dhe PM2,5)	Ndotësit përveç PM	PM (2) (shuma e PM10 dhe PM2,5)
0-249	1	2	1	1
250-499	2	3	1	2
500-749	2	3	1	2
750-999	3	4	1	2
1 000-1 499	4	6	2	3
1 500-1 999	5	7	2	3
2 000-2 749	6	8	3	4
2 750-3 749	7	10	3	4
3 750-4 749	8	11	3	6
4 750-5 999	9	13	4	6
≥ 6 000	10	15	4	7

(1) Për dioksidin e azotit, grimcat e materies, benzenin dhe monoksidin e karbonit: të përfshihet të paktën një stacion monitorimi për mjedisin urban dhe një stacion i orientuar nga trafiku me kusht që kjo gjë nuk e rrit numrin e pikave të marrjes së kampionëve. Për këta ndotës numri total i stacioneve në mjedis urban dhe numri total i stacioneve të orientuara nga trafiku në Shqipëri kërkuar sipas Seksionit A(1) nuk ndryshon me më shumë se faktori 2. Pikat e marrjes së kampionëve me tejkalime të vlerës kufi për PM10 brenda tre viteve të fundit ruhen, në qoftë se nuk është i nevojshëm një rilokalizim në sajë të rrethanave speciale, në veçanti zhvillimi hapësinor.

(2) Në rastet kur PM2,5 dhe PM10 maten në të njëjtin stacion monitorimi, këto do të numërohen si dy pika të veçanta monitorimi. Numri total i pikave të monitorimit PM2,5 dhe PM10 në Shqipëri kërkuar nga Seksioni A(1) nuk ndryshon me më shumë se faktori 2, dhe numri i pikave të monitorimit të PM2,5 në mjedisin urban të agregatëve dhe zonave urbane plotëson kërkesat sipas Seksionit B të Aneksit V.

2. Burimet pikë

Për vlerësimin e ndotjes në afërsi të burimeve pikë, numri i pikave për marrjen e kampionëve për matje fikse llogaritet duke marrë në konsideratë dendësitë e shkarkimeve, modelet e shpërndarjes së mundshme të ndotjes së ajrit të ambjentit dhe ekspozimin potencial të popullsisë.

B. Numri minimal i pikave të marrjes së kampionëve për matje fikse për të vlerësuar përmbushjen e synimit të pakësimit të ekspozimit të PM_{2,5} për mbrojtjen e shëndetit të njeriut.

Për këtë qëllim operon një pikë për marrje kampionesh për një milionë banorë e mbledhur mbi agregatët dhe zonat urbane shitesë që kanë më shumë se 100 000 banorë. Këto pika për marrjen e kampionëve mund të koincidojnë me pikat e marrjes së kampionëve sipas Seksionit A.

C. Numri minimal i pikave të marrjes së kampionëve për matje fikse për të vlerësuar respektimin e niveleve kritike për mbrojtjen e bimësisë në zonat përveç aglomeratëve.

Nëse përqendrimet maksimale tejkalojnë pragun e sipërm të vlerësimit	Nëse përqendrimet maksimale janë midis pragjeve të sipërme dhe të poshtme të vlerësimit
1 stacion çdo 20 000 km ²	1 stacion çdo 40 000 km ²

Në zonat ishull numri i pikave të marrjes së kampionëve për matje fikse llogaritet duke marrë në konsideratë modelet e shpërndarjes së mundshme të ndotjes së ajrit të ambjentit dhe ekspozimin potencial të bimësisë.

ANEKSI VI. Metodat referencë për vlerësimin e përqendrimeve të dioksidit të squfurit, dioksidit të azotit dhe oksideve të azotit, grimcave të materies (PM10 dhe PM2,5), plumbit, benzenit, monoksidit të karbonit dhe ozonit

Seksioni A. Metodat e matjes referencë

1. Metoda referencë për matjen e dioksidit të squfurit

Metoda referencë për matjen e dioksidit të squfurit është ajo që përshkruhet në EN 14212:2005 'Cilësia e ajrit të ambjentit — Metoda standard për matjen e përqendrimit të dioksidit të squfurit nga fluoreshenca ultravjollcë.

2. Metoda referencë për matjen e dioksidit të azotit dhe oksideve të azotit

Metoda referencë për matjen e dioksidit të azotit dhe oksideve të azotit është ajo që përshkruhet në EN 14211:2005 'Cilësia e ajrit të ambjentit — Metoda standarte për matjen e përqendrimit të dioksidit të azotit dhe monoksidit të azotit nga kimiluminishenca'.

3. Metoda referencë për marrjen e kampionëve dhe matjen e plumbit

Metoda referencë për marrjen e kampionëve të plumbit është ajo që përshkruhet në Seksionin A(4) të këtij Aneksi. Metoda referencë për matjen e plumbit është ajo që përshkruhet në EN 14902:2005 'Metoda standarde për matjen e Pb/Cd/As/Ni në fraksionin PM10 të grimcave pezull të materies'.

4. Metoda referencë për marrjen e kampionëve dhe matjen e PM10

Metoda referencë për marrjen e kampionëve dhe matjen e PM10 është ajo që përshkruhet në EN 12341:1999 'Cilësia e Ajrit — Përcaktimi i fraksionit PM10 i grimcave pezull të materies — Metoda referencë dhe procedura e testimit në terren për të demonstruar ekuivalencën referencë të metodave të matjes'.

5. Metoda referencë për marrjen e kampionëve dhe matjen e PM2,5

Metoda referencë për marrjen e kampionëve dhe matjen e PM2,5 është ajo që përshkruhet në EN 14907:2005 'Metoda e matjeve standarte gravimetrike për përcaktimin e fraksionit të masës PM2,5 të grimcave pezull të materies'.

6. Metoda referencë për marrjen e kampionëve dhe matjen e benzenit

Metoda referencë për matjen e benzenit është ajo që përshkruhet në EN 14662:2005, pjesa 1, 2 dhe 3 'Cilësia e ajrit të ambjentit — Metoda standarte për matjen e përqendrimeve të benzenit'.

7. Metoda referencë për matjen e monoksidit të karbonit

Metoda referencë për matjen e monoksidit të karbonit është ajo që përshkruhet në EN 14626:2005 'Cilësia e ajrit të ambjentit — Metoda standarte për matjen e përqendrimit të monoksidit të karbonit nga spektroskopi me rreze infra të kuqe jo shpërndarëse'.

8. Metoda referencë për matjen e ozonit

Metoda referencë për matjen e ozonit është ajo që përshkruhet në EN 14625:2005 'Cilësinë e ajrit të ambjentit — Metoda standarte për matjen e përqendrimit të ozonit nga fotometria ultravjollcë'.

Seksioni B. Demonstrimi i ekuivalencës

1. Ministria mund të përdorë çdo metodë tjetër që mund të demonstrojë se jep rezultate ekuivalente me ndonjë nga metodat e referuara në Seksionin A ose, në rastin e grimcave të materies, çdo metodë tjetër që Ministria mund të demonstrojë që shfaq marrëdhënie të qendrueshme me metodën referencë. Në atë rast rezultatet e arritura nga ajo metodë duhet të korrektohen për të prodhuar rezultate ekuivalente me ato që do të ishin arritur nëpërmjet përdorimit të metodës referencë.
2. Ministria përgatit dhe publikon dhe vë në dispozicion të publikut raportin për demonstrimin e ekuivalencës në përputhje me paragrafin 1.

Seksioni C. Standartizimi

1. Për ndotësit e gaztë vëllimi duhet të standartizohet në temperaturë 293 K dhe trysni atmosferike 101,3 kPa.
2. Për grimcat e materies dhe substancat që do të analizohen në grimcat e materies (p.sh. plumbi) vëllimi i marrjes së kampionëve i referohet kushteve të ambjentit në drejtim të temperaturës dhe trysnisë atmosferike në datën e matjeve.

Seksioni D. Prezantimi i paisjeve të reja

1. Të gjitha paisjet e reja të blera për zbatimin e këtij Vendimi duhet të jenë në përputhje me metodën referencë apo ekuivalentin e saj.
2. Të gjitha paisjet e përdorura në matjet fikse duhet të jenë në përputhje me metodën referencë apo ekuivalentin e saj deri më 11 Qershor 2013.

Seksioni E. Njohja reciproke e të dhënave

1. Gjatë kryerjes së aprovimit tip për të demonstruar që paisja plotëson kërkesat e performancës së metodave referencë të listuara në Seksionin A, Ministria, njësitë e qeverisjes vendore, pranojnë raportet e testimi të lëshuara në Shtetet e tjera nga laboratorët e akredituar me EN ISO 17025 për kryerjen e testeve të tilla.

ANEKSI VII. VLERAT E SYNUARA TË OZONIT DHE OBJEKTIVAT AFATGJATA

Seksioni A. Përkufizimet dhe kriteret

1. Përkufizimet

AOT40 (shprehur në $\mu\text{g}/\text{m}^3 \cdot \text{orë}$) është shuma e diferencës ndërmjet përqendrimeve për orë më të mëdha se $80 \mu\text{g}/\text{m}^3$ (= 40 pjesë për miliard) dhe $80 \mu\text{g}/\text{m}^3$ gjatë një periudhe kohore të dhënë duke përdorur vetëm vlerat një orëshe të matura ndërmjet Orës Qendrore Evropiane (CET) 8.00 dhe 20.00 çdo ditë.

2. Kriteret

Kriteret e mëposhtme përdoren për të kontrolluar vlefshmërinë kur bashkohen të dhënat dhe llogariten parametrat statistikorë:

Parametri	Proporcioni i kërkuar i të dhënave të vlefshme
Vlera një orëshe	75 % (që do të thotë 45 minuta)
Vlera tetë orëshe	75 % e vlerave (që do të thotë gjashtë orë)
Mesatarja maksimale ditore 8 orëshe nga 8 orë njëra pas tjetrës	75 % e mesatares për orë e tetë orëve njëra pas tjetrës (që do të thotë 18 mesatare tetë orëshe për ditë)
AOT40	90 % e vlerave një orëshe gjatë periudhës kohore të përcaktuar për llogaritjen e vlerës AOT40 (1)
Mesatarja vjetore	75 % e vlerave një orëshe gjatë verës (Prill deri në Shtator) dhe 75 % gjatë dimrit (Janar deri në Mars, Tetor deri në Dhjetor) stinët veç
Numri i tejkallimeve dhe vlerat maksimale për muaj	90 % të vlerave mesatare ditore maksimale tetë orëshe (27 vlera ditore të disponueshme për muaj) 90 % e vlerave një orëshe ndërmjet orës 8.00 dhe 20.00 CET
Numri i tejkallimeve dhe vlerat maksimale për vit	pesë nga gjashtë muaj gjatë stinës së verës (Prill deri Shtator)
<p>(1) Në rastet kur të gjitha të dhënat e matura të mundshme nuk janë të disponueshme, faktori i mëposhtëm përdoret për të kalkuluar vlerat AOT40: $AOT40 \text{ e llogaritur} = AOT40 \text{ e matur} \times \text{numri total i mundshëm i orëve (*)} / \text{numri i vlerave të të matura për orë}$</p> <p>(*)numri i orëve brenda periudhës kohore të përkufizimit të AOT40, (që do të thotë 08:00 deri në 20:00 CET nga 1 Maj deri në 31 Korrik çdo vit, për mbrojtjen e bimësisë dhe nga 1 Prill deri në 30 Shtator çdo vit për mbrojtjen e pyjeve).</p>	

Seksioni B. Vlerat e synuara

Objekti	Periudha mesatare	Vlera e synuar	Data në të cilën duhet përbushur vlera e synuar (1)
Mbrojtja e shëndetit të of human health	Mesatarja maksimale ditore tetë orëshe (2)	120 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ të mos tejkallohet në më shumë se 25 ditë për vit kalendarik	1.1.2010

		mesatarisht gjatë tre vjetëve (3)	
Mbrojtja e bimësisë	Maj deri Korrik	AOT40 (llogaritur nga vlerat 1 orëshe) 18 000 µg/m ³ · h mesatarisht gjatë pesë vjetëve (3)	1.1.2010
<p>(1) Respektimi i vlerave të synuara do të vlerësohet nga kjo datë. Kjo do të thotë që 2010 do të jetë viti i parë të dhënat e të cilin do të përdoren në llogaritjen e respektimit gjatë tre apo pesë viteve vijuese, sipas rastit.</p>			
<p>(2) Përqendrimi i mesatares maksimale ditore tetë orëshe do të përzgjidhet duke ekzaminuar mesataret e tetë orëve njëra pas tjetrës, llogaritur nga të dhënat për orë dhe të përditësuara çdo orë. Çdo mesatare tetë orëshe e llogaritur kështu do t'i caktohet ditës në të cilën mbaron që do të thotë periudha e parë e llogaritjes për çdonjërin nga ditët do të jetë periudha nga ora 17:00 e ditës së mëparshme deri në orën 01:00 të asaj dite; periudha e fundit e llogaritjes për çdonjërin nga ditët do të jetë periudha nga ora 16:00 deri në orën 24:00 të asaj dite.</p>			
<p>(3) Nëse mesataret tre ose pesë vjetore nuk mund të përcaktohen në bazë të një kompleti të plotë dhe konsektiv të dhënash vjetore, të dhënat vjetore minimale të kërkuara për të kontrolluar respektimin e vlerave të synuara do të jenë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> — për vlerat e synuara për mbrojtjen e shëndetit të njeriut: të dhënat e vlefshme për një vit, — për vlerën e synuar për mbrojtjen e bimësisë: të dhënat e vlefshme për tre vjet 			

Seksioni C. Objektivat afatgjata

Objektivi	Periudha mesatare	Objektiva afatgjata	Data në të cilën duhet të përmbushet objektivi afatgjatë
Mbrojtja e shëndetit të njeriut	Mesatarja maksimale ditore tetë orëshe brenda një viti kalendarik	120 µg/m ³	
Mbrojtja e bimësisë	Maj deri në Korrik	AOT40 (llogaritur nga vlerat 1 orëshe) 6 000 µg/m ³ · h	

ANEKSI VIII. Kriteret për klasifikimin dhe lokalizimin e pikave të marrjes së kampionëve për vlerësimet e përqendrimeve të ozonit

Sa më poshtë zbatohen tek matjet fikse:

A. Përcaktimi i territorit në shkallë makro

Tipi i stacionit	Objectivat e matjes	Përfaqësimi (1)	Kriteret e përcaktimit të territorit në shkallë makro
Urban	Mbrojtja e shëndetit të njeriut: të vlerësojë ekspozimin e popullsisë urbane ndaj ozonit, që do të thotë aty ku dendësia e popullsisë dhe përqendrimi i ozonit janë relativisht të larta dhe përfaqësuese të ekspozimit të publikut në përgjithësi	Disa km ²	Larg influencës së shkarkimeve lokale si trafiku, pikat e furnizimit me karburant, etj.; Vendet e ventiluara ku nivelet e përzjera mirë mund të maten; Vendet si zonat e banimit dhe zonat komerciale të qyteteve, parqet (larg nga pemët), rrugët apo sheshet e mëdha me shumë pak apo aspak trafik, zonat e hapura karakteristike për fasilite edukative, sportive apo shplohëse
Nënurban	Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe bimësisë: të vlerësohet ekspozimi i popullsisë dhe bimësisë që ndodhet në periferitë e agregatit, ku janë nivelet më të larta të ozonit, ndaj të cilit popullsia dhe bimësia kanë gjasa të jenë të ekspozuar drejtpërsëdrejti apo jo drejtpërsëdrejti	Disa dhjetra km ²	Në një distancë të caktuar nga zona e shkarkimeve maksimale, në drejtim të erës në vijëmbësi të drejtimit/drejttimeve kryesore të erës gjatë kushteve të favorshme për formimin e ozonit; në rastet kur popullsia, të lashtat e ndjeshme apo ekosistemet natyrore që ndodhen në perimetrin e jashtëm të një agregati janë të ekspozuar në nivele të larta ozoni; kur duhet, disa stacione nënurbane gjithashtu në drejtim të kundërt të erës së shkarkimeve maksimale me qëllim që të përcaktohen nivelet rajonale të ozonit
Rural	Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe bimësisë: të vlerësohet ekspozimi i	Nivelet nën-rajonale (disa qindra km ²)	Stacionet mund të vendosen në small qendra banimi të vogla dhe /ose zona me

	popullsisë dhe të lashtave dhe ekosistemeve natyrore ndaj përqendrimeve të ozonit në shkallë nën rajonale		ekosisteme natyrore, pyje ose të lashta; rërfaqësues për ozonin larg nga influence e shkarkimeve lokale të menjëhershme siç janë instalimet industriale dhe rrugët; në territoret me zona të hapura, por jo në majat e maleve më të larta
Mjedisi Rural	Mbrojtja e bimësisë dhe shëndetit të njeriut: të vlerësohet ekspozimi i të lashtave dhe ekosistemeve natyrore ndaj përqendrimeve të ozonit në shkallë nën rajonale si edhe ekspozimi i popullsisë	Nivelet rajonale/kombëtare/kontinentale (1 000 deri në 10 000 km ²)	Stacion i vendosur në zona me dendësi më të vogël popullore, p.sh. me ekosisteme natyrore, pyje, në një distancë prej të paktën 20 km nga zonat urbane dhe industriale dhe larg nga shkarkimet lokale; të shmangen vendodhjet që janë subjekt i formimit të shtuar lokalisht të kushteve të kundërta pranë tokës, gjithashtu majat e maleve më të larta; zonat bregdetare me cikle erërash të përditshme të shpallura ëith me karakter lokal nuk rekomandohen.
(1) Pikat e marrjes së kampionëve duhet, kur është e mundur, të jenë përfaqësuese të vendeve të njëjta që nuk ndodhet në afërsinë e tyre direkte.			

Për stacionet rurale dhe ato në mjedis rural vendodhja do të, kur duhet, koordinohet me kërkesat për monitorimin e pyjeve dhe ndërveprimet mjedisore.

B. Përcaktimi i territorit në shkallën mikro

Për atë që është e praktikueshme do të ndiqet procedura në përcaktimin e territorit në shkallë mikro në Seksionin C të Aneksit III, duke siguruar që sonda hyrëse pozicionohet tepër larg nga burime të tilla si furnalata dhe oxhakë incinerimi dhe më shumë se 10m larg nga rruga më e afërt, me distancë që rritet si funksion i intensitetit të trafikut.

C. Dokumentacioni dhe rishikimi i përzgjedhjes së territorit

Procedurat në Seksionin D të Aneksit III duhen ndjekur, duke zbatuar ekzaminimin/shoshitjen dhe interpretimin e duhur të të dhënave monitoruese

në kontekstin e proçeseve meteorologjike dhe fotokimike që ndikojnë përqendrimet e ozonit të matura në territoret përkatëse.

ANEKSI IX. Kriteret për përcaktimin e numrit minimal të pikave për marrjen e kampionëve për matjen fikse të përqendrimeve të ozonit

Seksioni A. Numri minimal i pikave për marrjen e kampionëve për matjet fikse të vazhdueshme për të vlerësuar respektimin e vlerave të synuara, objektivat afatgjata dhe informacionin dhe pragjet alarm në rastet kur matje të tilla janë burimi i vetëm i informacionit

Popullsia (× 1 000)	Agregatët (urbanë dhe nënurbanë) (1)	Zona të tjera (nënurbane dhe rurale) (1)	Mjedisi rural
< 250		1	1 stacion/50 000 km ² si dendësit mesatare e të gjithë agregatëve për vend (2)
< 500	1	2	
< 1 000	2	2	
< 1 500	3	3	
< 2 000	3	4	
< 2 750	4	5	
< 3 750	5	6	
> 3 750	Një stacion shtesë për 2 milionë banorë	Një stacion shtesë për 2 milion banorë	
(1) Të paktën 1 stacion në zonat nënurbane, ku ka gjasa të ketë ekspozim të lartë të popullsisë. Tek agregatët të paktën 50 % e stacioneve do të vendosen në zona nënurbane.			
(2) Rekomandohet 1 stacion për 25 000 km ² për terrenet komplekse.			

Seksioni B. Numri minimal i pikave për marrjen e kampionëve për matjet fikse për zonat dhe aglomeratët që arrijnë objektivat afatgjata

Numri i pikave për marrjen e kampionëve për ozonin, në kombinim me mjete të tjera vlerësimi shtesë siç janë modelimi i cilësisë së ajrit dhe matjet e renditura të dioksidit të azotit, do të jetë i mjaftueshëm për të ekzaminuar tendencën e ndotjes së ozonit dhe për të kontrolluar përmbushjen e objektiveve afatgjata. Numri i stacioneve të vendosura në agregatë dhe zona të tjera mund të pakësohet në një të tretën e numrit të specifikuar në Seksionin A. Në rastet kur informacioni nga stacionet e matjeve fikse është burimi i vetëm i informacionit, duhet mbajtur të paktën një stacion monitorimi. Nëse, në zonat ku ka vlerësim shtesë, del si rezultat që zona nuk ka asnjë stacion të mbetur, koordinimi me numrin e stacioneve në zonat fqinjë do të sigurojë vlerësimin e duhur të përqendrimeve të ozonit ndaj objektiveve afatgjata. Numri i stacioneve me karakter rural do të jetë një për 100 000 km².

ANEKS X. MATJET E SUBSTANCAVE PARARENDËSE TË OZONIT

Seksioni A. Objektivat

1. Objektivat kryesore të matjeve të tilla janë të analizojnë çdo tendencë në pararendësit e ozonit, të kontrollojnë efikasitetin e strategjive të pakësimit të shkarkimeve, të kontrollojnë konsistencën e inventarëve të shkarkimeve dhe t'ia atribuojnë përqendrimit e vëzhguara të ndotjes burimeve të shkarkimit.
2. Një qëllim shtesë është të mbështesë kuptimin e formacionit të ozonit dhe proceset pararendëse të shpërhapjes si edhe zbatimin e modeleve fotokimike.

Seksioni B. Substancat

1. Matja e substancave pararendëse të ozonit përfshin të paktën oksidet e azotit (NO dhe NO₂), dhe përbërjet e përshtatshme organike të paqëndrueshme (VOC). Më poshtë jepet lista e përbërjeve organike të paqëndrueshme rekomanduar për matje:

	1-Buteni	Izopreni	Etil benzeni
Etani	Trans-2-Buteni	n-Hekzani	m + p-Ksileni
Etileni	cis-2-Buteni	i-Hekzani	o-Ksileni
Acetileni	1,3-Butadieni	n-Heptani	1,2,4-Trimetilbenzeni
Propani	n-Pentani	n-Oktani	1,2,3-Trimetilbenzeni
Propeni	i-Pentani	i-Oktani	1,3,5-Trimetilbenzeni
n-Butani	1-Penteni	Benzeni	Formaldehid
i-Butani	2-Penteni	Tolueni	Hidrokarburet totale jo-metan

Seksioni C. Përcaktimi i territorit

1. Matjet duhen kryer veçanërisht në zona urbane apo nënurbane në cilindo territor monitorimi të ndërtuar në përputhje me kërkesat e këtij Vendimi dhe të konsideruar të përshtatshëm për sa i përket objektivave të monitorimit të referuara në Seksionin A.

ANEKSI XI. VLERAT KUFI PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT TË NJERIUT

Seksioni A. Kriteret

1. Pa paragjykuar Aneksin I, kriteret e mëposhtme do të përdoren për të kontrolluar vlefshmërinë gjatë bashkimit të të dhënave dhe llogaritjes së parametrevë statistikore:

Parametri	Porcioni i kërkuar për të dhëna të vlefshme
Vlerat një orëshe	75 % (që do të thotë 45 minuta)
Vlerat tetë orëshe	75 % e vlerave (që do të thotë 6 orë)
Mesatarja maksimale ditore e tetë orëve	75 % e mesatareve për orë të tetë orëve njëra pas tjetrës (që do të thotë 18 mesatare tetë orëshe në ditë)
Vlerat 24-orëshe	75 % e mesatareve për çdo orë (që do të thotë të paktën vlerat për 18 orë)
Mesatarja vjetore	90 % (1) e vlerave një orëshe ose (nëse nuk janë të disponueshme) vlerat 24-orëshe përgjatë vitit
(1) Kërkesat për llogaritjen e mesatares vjetore nuk përfshijnë humbjet e të dhënave për shkak të kalibrimit të rregullt apo mirëmbajtjes normale të përdorimit të instrumentave.	

Seksioni B. Vlerat kufi

Periudha mesatare	Vlera kufi	Marzhi i tolerancës	Data në të cilën vlera kufi duhet të përmbushet
Dioksidi i sqfurit			
Një orë	350 µg/m ³ , të mos tejkalohet me më shumë se 24 herë gjatë një viti kalendarik	150 µg/m ³ (43 %)	— (1)
Një ditë	125 µg/m ³ , të mos tejkalohet me më shumë se 3 herë gjatë një viti kalendarik	Asnjë	— (1)
Dioksidi i azotit			
Një orë	200 µg/m ³ , të mos tejkalohet me më shumë se 18 herë gjatë një viti kalendarik	50 % me 19 Korrik 1999, në rënie më 1 Janar 2001 dhe çdo 12 muaj më pas me përqindje të barabarta vjetore për të arritur në 0 % më 1 Janar 2010	1 Janar 2010
Viti kalendarik	40 µg/m ³	50 % me 19 Korrik 1999, në rënie më 1 Janar 2001 dhe çdo 12 muaj më pas me përqindje të barabarta vjetore për të arritur në 0 % më 1 Janar 2010	1 Janar 2010
Benzeni			
Viti kalendarik	5 µg/m ³	5 µg/m ³ (100 %) më 13 Dhjetor	1 Janar 2010

Periudha mesatare	Vlera kufi	Marzhi i tolerancës	Data në të cilën vlera kufi duhet të përmbushet
		2000, në rënie më 1 Janar 2006 dhe çdo 12 muaj më pas me 1 µg/m ³ për të arritur në 0 % më 1 Janar 2010	
Monoksidi i karbonit			
Mesatarja mesatare ditore tetë orëshe (2)	10 mg/m ³	60 %	— (1)
Plumbi			
Viti kalendarik	0,5 µg/m ³ (3)	100 %	— (3)
PM-10			
Një ditë	50 µg/m ³ , të mos tejkalohet me më shumë se 35 herë gjatë një viti kalendarik	50 %	— (1)
Viti kalendarik	40 µg/m ³	20 %	— (1)
(1) Tashmë në fuqi që prej datës 1 Janar 2005			
(2) Përqëndrimi mesatar ditor tetë orësh do të përzgjidhet nga ekzaminimi i mesatareve të tetë orëve njëra pas tjetrës, llogaritur nga të dhënat e çdo ore dhe të përditësuar çdo orë. Çdo mesatare tetë orëshe e llogaritur në këtë mënyrë do t'i caktohet ditës në të cilën mbaron që do të thotë se periudha e llogaritjes së parë për çdonjërin nga ditët do të jetë periudha nga ora 17:00 e ditës së mëparshme deri në orën 01:00 të asaj dite; periudha e llogaritjes së fundit për çdonjërin nga ditët do të jetë periudha nga ora 16:00 deri në orën 24:00 të asaj dite.			
(3) Tashmë në fuqi që prej datës 1 Janar 2005. Vlera kufi të plotësohet vetëm më 1 Janar 2010 në afërsinë direkte të burimeve të zonave industriale specifike që ndodhen në territore të ndotura për dekada me rradhë nga aktivitetet industriale. Në raste të tilla, vlera kufi deri më 1 Janar 2010 do të jetë 1,0 µg/m ³ . Zona në të cilën zbatohen vlera kufi më të larta nuk duhet të shtrihet më larg se 1 000 m nga burime të tilla specifike.			

ANEKS XII. INFORMACIONI DHE PRAGJET ALARM

Seksioni A. Pragjet alarm për ndotësit përveç ozonit

Të maten gjatë tre orëve të njëpasnjëshme në vende përfaqësuese të cilësisë së ajrit përgjatë të paktën 100 km² ose një zone apo agregati të tërë, cilido qoftë më i vogël.

Ndotësi	Pragu alarm
Dioksidi i squfurit	500 µg/m ³
Dioksidi i azotit	400 µg/m ³

Seksioni B. Informacioni dhe pragjet alarm për ozonin

Qëllimi	Periudha mesatare	Pragu
Informacioni	1 orë	180 µg/m ³
Alarmi	1 orë (1)	240 µg/m ³

(1) Për zbatimin e Paragrafëve 68 dhe 100, tejkalimi i pragut do të matet apo parashikohet për tre orë të njëpasnjëshme.

ANEKSI XIII. NIVELET KRITIKE PËR MBROJTJEN E BIMËSISË

Periudha mesatare	Niveli kritik	Marzhi i tolerancës
Dioksidi i squfurit		
Viti kalendarik dhe dimri (1 Tetor deri 31 Mars)	20 µg/m ³	Asnjë
Oksidet e azotit		
Viti kalendarik	30 µg/m ³ NO _x	Asnjë

ANEKSI XIV. SYNIMI I PAKËSIMIT TË EKSPOZIMIT KOMBËTAR, VLERA E SYNUAR DHE VLERA KUFI PËR PM-2,5

Seksioni A. Treguesi i ekspozimit mesatar

1. Treguesi i Ekspozimit Mesatar shprehur në $\mu\text{g}/\text{m}^3$ (TEM) do të bazohet mbi matjet në vendet me karakter urban në zonat dhe agregatët nëpër të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Duhet vlerësuar si përqendrim mesatar vjetor i tre viteve kalendarike në vijimësi mesatarizuar përgjatë gjithë pikave të marrjes së kampionëve të ngritura në bazë të Seksionit B të Aneksit V. TEM për vitin referencë 2010 do të jetë përqendrimi mesatar i viteve 2008, 2009 dhe 2010.
2. Megjithatë, në rastet kur të dhënat e vitit 2008 nuk janë të disponueshme, Ministria mund të përdorë përqendrimin mesatar të viteve 2009 dhe 2010 ose përqendrimin mesatar të viteve 2009, 2010 dhe 2011.
3. TEM për vitin 2020 do të jetë përqendrimin mesatar i tre viteve në vijimësi mesatarizuar përgjatë gjithë pikave të marrjes së kampionëve për vitet 2018, 2019 dhe 2020. TEM përdoret për ekzaminim nëse është arritur synimi për pakësimin e ekspozimit kombëtar.
4. TEM për vitin 2015 do të jetë përqendrimin mesatar i tre viteve në vijimësi mesatarizuar përgjatë gjithë pikave të marrjes së kampionëve për vitet 2013, 2014 dhe 2015. TEM përdoret për ekzaminim nëse është arritur detyrimi për përqendrimin e ekspozimit.

Seksioni B. Synimi i pakësimit të ekspozimit kombëtar

Synimi i pakësimit të ekspozimit në lidhje me TEM në vitin 2010	Viti në të cilin duhet të plotësohet synimi për pakësimin e ekspozimit
Përqendrimet fillestare në $\mu\text{g}/\text{m}^3$	
< 8,5 = 8,5	
> 8,5 — < 13	
= 13 — < 18	
= 18 — < 22	
≥ 22	
Synimi i pakësimit në përqindje	
10. 0%	
12. 10%	
14. 15%	
16. 20%	
Të gjitha masat për të arritur 18 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	
	2020

1. Kur TEM në vitin referencë është 8,5 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ apo më pak synimi i pakësimit të ekspozimit do të jetë zero.
2. Synimi i pakësimit do të jetë zero gjithashtu në rastet kur TEM arrin nivelin e 8,5 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ në çfarëdo lloj kohe gjatë periudhës nga viti 2010 deri në vitin 2020 dhe mbahet në ose nën atë nivel.

Seksioni C. Detyrimi për përqendrimin e ekspozimit

Detyrimi i përqendrimin të ekspozimit	Viti në të cilin duhet të plotësohet vlera e detyrimit
---------------------------------------	--

20. 20 µg/m ³	2015
--------------------------	------

Seksioni D. Vlera e synuar

Periudha mesatare	Vlera e synuar	Data në të cilën duhet të plotësohet vlera e synuar
Viti kalendarik	25 µg/m ³	1 Janar 2010

Section E. Limit value

Periudha mesatare	Vlera kufi	Marzhi i tolerancës	Data në të cilën duhet të plotësohet vlera kufi
FAZA 1			
Viti kalendarik	25 µg/m ³	20 % më 11 Qershor 2008, në rënie në 1 Janarin e ardhshëm dhe çdo 12 muaj më pas me përqindje të barabarta vjetore për të arritur në 0 % më 1 Janar 2015	1 Janar 2015
FAZA 2 (1)			
Viti kalendarik	20 µg/m ³		1 Janar 2020
(1) Faza 2 — vlera treguese kufi të rishikohet nga Ministri në 2013 nga pikëpamja e informacionit të mëtejshëm mbi efektet ndaj shëndetit dhe mjedisit, fizibilitetit teknik dhe eksperiencës së vlerës së synuar.			

ANEKSI XV. Informacioni që duhet përfshirë në planet lokale, rajonale dhe kombëtare të cilësisë së ajrit për përmirësimin e cilësisë së ajrit në ambjent

Seksioni A. Informacioni që duhet ofruar sipas Paragrafit 93 (planet e cilësië së ajrit)

1. Lokalizimi i ndotjes së tepërt
 - (a) rajoni;
 - (b) qyteti (harta);
 - (c) stacioni i matjes (harta, koordinatat gjeografike).

2. Informacion i përgjithshëm
 - (a) tipi i zonës (qytet, zonë industriale apo rurale);
 - (b) vlerësimi i zonës së ndotur (km²) dhe i popullsisë së ekspozuar ndaj ndotjes;
 - (c) të dhënat klimatike të dobishme;
 - (d) të dhëna që kanë lidhje me topografinë;
 - (e) informacion i mjaftueshëm për tipin e synimeve që kërkojnë mbrojtje në zonë.

3. Autoritetet përgjegjëse
Emrat dhe adresat e personave përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e planeve të përmirësimit.

4. Natyra dhe vlerësimi i ndotjes
 - (a) përqendrimet e vëzhguara gjatë viteve të mëparshme (përpara zbatimit të masave të përmirësimit);
 - (b) përqendrimet e matura që nga fillimi i projektit;
 - (c) teknikat e përdorura për vlerësim.

5. Origjina e ndotjes
 - (a) lista e burimeve kryesore të shkarkimeve përgjegjëse për ndotjen (harta);
 - (b) sasia totale e shkarkimeve nga këto burime (tonë/vit);
 - (c) informacion për ndotjen importuar nga rajonet e tjera.

6. Analiza e situatës
 - (a) hollësi të faktorëve përgjegjës për tejkalimin (p.sh. transporti, përfshirë transportin ndërkufitar, formimin e ndotësve dytësore në atmosferë);
 - (b) hollësi të masave të mundshme për përmirësimin e cilësisë së ajrit.

7. Hollësi të masave ose projekteve për përmirësim që kanë ekzistuar përpara datës 11 Qershor 2008, që do të thotë:
 - (a) masat lokale, rajonale, kombëtare, ndërkombëtare;
 - (b) efekte të vëzhguara të këtyre masave.

8. Hollësi të masave ose projekteve të miratuara me synimin për të pakësuar ndotjen pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi:

- (a) listimi dhe përshkrimi i të gjitha masave të përcaktuara në projekt;
- (b) grafiku i zbatimit;
- (c) vlerësimi i përmirësimit të planifikuar të cilësisë së ajrit dhe i kohës së pritur për të arritur këto objektiva.

9. Hollësi të masave ose projekteve të planifikuara ose të kërkuara për periudha afatgjata.

10. Lista e botimeve, dokumentave, punës, etj., përdorur për të plotësuar informacionin e kërkuar sipas këtij Aneksi.

Seksioni B. Informacion që duhet ofruar sipas Paragrafit 87

1. Gjithë informacioni siç parashtrohet në Seksionin A.
2. Informacion në lidhje me statusin e zbatimit të legjislacionit të mëposhtëm:
 - a. për masat që duhen marrë ndaj ndotjes së ajrit nga shkarkimet e automjeteve;
 - b. për kontrollin e shkarkimeve të përbërjeve organike të paqëndrueshme (VOC) që rezultojnë nga depozitimi i benzinës dhe shpërndarjes së saj nga терминаlet në stacionet e shërbimit;
 - c. për parandalimin dhe kontrollin e integruar të mbetjeve;
 - d. në lidhje me masat ndaj shkarkimit të ndotësve të gaztë dhe në formë grimcash nga motorët me djegie të brendshme që instalohen në makineri të lëvizshme jo rrugore;
 - e. në lidhje me cilësinë e benzinës dhe karburantet dizel;
 - f. për kufizimet e shkarkimeve të përbërjeve organike të paqëndrueshme për shkak të përdorimit të tretësve organike në disa aktivitete dhe instalime;
 - g. në lidhje me pakësimin e përmbajtjes së squfurit tek disa karburante të lëngshëm;
 - h. për incinerimin e mbetjeve;
 - i. për kufizimin e shkarkimeve të disa ndotësve në ajër nga impiantet e mëdha të djegieve;
 - j. për tavanet e shkarkimeve kombëtare për disa ndotës atmosferikë;
 - k. për kufizimin e shkarkimeve të përbërjeve organike të paqëndrueshme tek disa bojëra dhe llakra dhe produktet për lustrimin e makinave;
 - l. për përmbajtjen e squfurit në karburantet detare;
 - m. në lidhje me masat që merren ndaj shkarkimit të ndotësve të gaztë dhe në formë grimcash nga motorët me injektim pneumatik për përdorim në makina dhe shkarkimi i ndotësve të gaztë nga motorët me injektim - pozitiv që përdorin si karburant gazin natyror ose naftën e lëngshme për përdorim në makina;
 - n. për efikasitetin në përdorimin përfundimtar të energjisë dhe shërbimet e energjisë.
3. Informacion për të gjitha masat për pakësimin e ndotjes së ajrit që janë konsideruar në nivel lokal, rajonal apo kombëtar për zbatimin në lidhje me arritjen e objektivave për cilësinë e ajrit, përfshirë:

- a. pakësimi i shkarkimeve nga burimet e palëvizshme duke siguruar që burimet ndotëse të palëvizshme të djegies (përfshirë ato për biomasën) si të vogla dhe të mesme janë përshtatur me paisje për kontrollin e shkarkimeve ose janë zëvendësuar;
- b. pakësimi i shkarkimeve nga makinat nëpërmjet vendosjes së paisjeve për kontrollin e shkarkimeve. Duhet konsideruar përdorimi i stimujve ekonomikë për të përshpejtuar adoptimin/përshtatjen;
- c. prokurimi nga autoritetet publike, në përputhje me manualin për prokurimet publike mjedisore, i makinave rrugore, karburanteve dhe paisjeve me djegie për të pakësuar shkarkimet, përfshirë blerjen e:
 - (i) makinave të reja, përfshirë makinat më shkarkime të ulëta,
 - (ii) shërbimet e transportit të makinave më të pastra,
 - (iii) burimet e palëvizshme të djegies me shkarkime të ulëta,
 - (iv) karburantet me shkarkime të ulëta për burimet e palëvizshme dhe të lëvizshme,
- d. masat për të kufizuar shkarkimet e transportit nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit të trafikut (përfshirë përcaktimin e çmimit të kongjestimit, tarifave të diferencuara të parkimit apo stimuj të tjerë ekonomikë; krijimi i zonave me shkarkime të ulëta);
- e. masat për të inkurajuar një zhvendosje të transportit drejt mënyrave më pak ndotëse;
- f. duke siguruar që karburantet me shkarkime të ulëta përdoren në burimet e palëvizshme në shkallë të vogël, të mesme dhe të madhe dhe në burimet e lëvizshme;
- g. masat për pakësimin e ndotjes së ajrit nëpërmjet sistemit të lejes mjedisore, planeve të shkarkimeve kombëtare, dhe nëpërmjet përdorimit të instrumentave ekonomikë siç janë taksat, ngarkesat apo tregtimi i shkarkimeve.
- h. kur duhet, masat për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve apo grupeve të tjera të ndjeshme.

ANEKSI XVI. INFORMIMI I PUBLIKUT

1. Ministria siguron që informacioni i përditësuar për përqendrimet e ndotësve në ambjent trajtuar nga ku Vendim vihet në dispozicion të publikut në mënyrë rutinë.
2. Përqendrimet në ambjent të ofruara duhet të prezantohen si vlera mesatare sipas periudhës mesatare të duhur siç përcaktohet në Aneksin VII dhe Anekset XI deri në XIV. Informacioni duhet të paktën të tregojë çdo nivel që tejkalon objektivat e cilësisë së ajrit përfshirë vlerat kufi, vlerat e synyara, pragjet alarm, pragjet e informacionit apo objektivat afatgjata të ndotësit të rregulluar. Gjithashtu duhet të përmbajë një vlerësim të shkurtër në lidhje me objektivat e cilësisë së ajrit dhe informacionin e duhur përsa i përket efekteve tek shëndeti, apo, kur duhet, tek bimësia.
3. Informacioni për përqendrimet në ambjent të dioksidit të squfurit, dioksidit të azotit, grimcave të materies (të paktën PM-10), ozonit dhe monoksidit të karbonit duhet të përditësohet të paktën çdo ditë, dhe kurdo që është e praktikueshme, informacioni duhet të përditësohet çdo orë. Informacioni për përqendrimet në ambjent të plumbit dhe benzenit, prezantuar si vlerë mesatare për 12 muajt e fundit, duhet të përditësohet çdo tre muaj, dhe kurdo që është e praktikueshme çdo muaj.
4. Ministria siguron që publikut i jepet informacioni në kohë rreth tejkalimeve aktuale apo të parashikuar të pragjeve alarm si dhe çdo prag informacioni. Hollësitë e dhëna duhet të përfshijnë të paktën informacionin e mëposhtëm:
 - a. Informacion për tejkalimin (et) e vëzhguara:
 - i. vendin apo zonën e tejkalimit,
 - ii. tipin e pragut të tejkaluar (informacion ose alarm),
 - iii. kohën e fillimit dhe kohëzgjatjen e tejkalimit,
 - iv. përqendrimin më të lartë një orësh si edhe përqendrimin e mesatares më të lartë të tetë orëve në rastin e ozonit;
 - b. Parashikimi për pasditen / ditën(t) vijuese:
 - i. zona gjeografike e tejkalimeve të pritura për informacionin dhe/ose pragun e alarmit,
 - ii. ndryshimet e pritura tek ndotja (përmirësimi, stabilizimi apo përkeqësimi), së bashku me arsyet për këto ndryshime;
 - c. Informacion për tipin e popullsisë që ka lidhje, efekte e mundshme tek shëndeti dhe sjellja e rekomanduar:
 - i. informacion për grupet e popullsisë në rrezik,
 - ii. përshkrim i simptomave mundshme,
 - iii. masat paraprake të rekomanduara për t'u marrë nga popullsia që ka lidhje,
 - iv. ku të gjendet informacion i mëtejshëm;

- d. Informacion për masat parandaluese për të pakësuar ndotjen dhe/ose ekspozimin ndaj saj: tregimi i sektorëve të burimeve kryesore; rekomandime për veprimet për pakësimin e shkarkimeve;
- e. Në rastin e tejkalimeve të parashikuara, Ministria merr masa për të siguruar që këto hollësi jepen në shkallë të përdorshme.

ANEKSI XVII. Vlerat e synuara për arsenikun, kadmiumin, nikelin dhe benzo(a)pirenin

Ndotësi	Vlera e synuar (1)
Arseniku	6 ng/m ³
Kadmiumi	5 ng/m ³
Nikeli	20 ng/m ³
Benzo(a)pireni	1 ng/m ³
(1) Për përmbajtjen totale në fraksionin PM10 të mesatarizuar gjatë një viti kalendarik.	

ANEKSI XVIII. Përcaktimi i kërkesave për vlerësimin e përqendrimeve të arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit në ajrin e ambjentit brenda një zonë apo agregati

I. Pragjet e sipërme dhe të poshtme të vlerësimit

Zbatohen pragjet e sipërme dhe të poshtme të vlerësimit të dhëna më poshtë:

	Arseniku	Kadmiumi	Nikeli	B(a)P
Pragu i sipërm i vlerësimit në përqindje të vlerës së synuar	60 % (3,6 ng/m ³)	60 % (3 ng/m ³)	70 % (14 ng/m ³)	60 % (0,6 ng/m ³)
Pragu i poshtëm i vlerësimit në përqindje të vlerës së synuar	40 % (2,4 ng/m ³)	40 % (2 ng/m ³)	50 % (10 ng/m ³)	40 % (0,4 ng/m ³)

II. Përcaktimi i tejkalimeve të pragjeve të sipërme dhe të poshtme të vlerësimit

1. Tejkalimet e vlerësimeve të pragjeve të sipërme dhe të poshtme duhet të vendosen në bazë të përqendrimeve gjatë pesë viteve kur janë të disponueshme të dhëna të mjaftueshme. Një prag vlerësimi do të konsiderohet se është tejkaluar nëse ai është tejkaluar gjatë tre viteve kalendarike nga pesë vitet e mëparshme.
2. Në rastet kur ka të dhëna të disponueshme për më pak se pesë vjet, Ministria mund të kombinojë fushatat e matjeve me kohëzgjatje të shkurtër gjatë periudhës së një viti dhe në vendet që kanë gjasa të jenë tipike të niveleve më të larta të ndotjes me rezultatet e përfruara nga informacioni i inventarëve të shkarkimeve dhe modelimi për të përcaktuar tejkalimet e pragjeve të sipërme dhe të poshtme të vlerësimit.

ANEKSI XIX. Vendodhja dhe numri minimal i pikave për marrjen e kampionëve për matjen e përqendrimeve në ajrin e ambjentit dhe normat e depozitimit

I. Përcaktimi i territorit në shkallë makro

1. Territoret për marrjen e kampionëve duhet të përzgjidhen në mënyrë të tillë që:
 - a. të ofrojnë të dhëna për territoret brenda zonave dhe aglomeratëve në të cilat popullsia ka gjasa të ekspozohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jot ë drejtpërdrejtë ndaj përqendrimeve më të larta të mesatarizuara përgjatë një viti kalendarik;
 - b. të ofrojnë të dhëna për nivelet në territoret e tjera brenda zonave dhe aglomeratëve që janë përfaqësues të ekspozimit të popullsisë në përgjithësi;
 - c. të ofrojnë të dhëna për normat e depozitimit që përfaqësojnë ekspozimin jo të drejtpërdrejtë të popullsisë nëpërmjet zinxhirit të ushqimit.
2. Pikat për marrjen e kampionëve duhet të vendosen në territore të tilla që të shmanget matja e mikro-mjediseve shumë të vogla në afërsinë e tyre direkte. Si udhëzim, një pikë për marrjen e kampionëve duhet të jetë përfaqësuese e cilësisë së ajrit në zonat rrethuese prej jo më pak se 200 m² në territoret e orientuara nga trafiku, të paktën 250 m x 250 m në zonat industriale, kur është e mundur, dhe disa kilometra katrorë në territoret me karakter urban.
3. Në rastet kur objektivi është vlerësimi i niveleve të mjedisit/sfondit territori i marrjes së kampionëve nuk duhet të influencohet nga agregatët apo zonat industriale në afërsi të tij që do të thotë më afër se disa kilometra.
4. Në rastet kur do të vlerësohen kontributet nga burimet industriale të paktën një pikë për marrjen e kampionëve duhet instaluar në drejtim të erës së burimit në zonën e banimit më të afërt. Në rastet kur nuk dihet përqendrimi i mjedisit/sfondit, duhet vendosur një pikë shtesë për marrjen e kampionëve në drejtimin kryesor të erës. Në veçanti, në rastet kur tejkalohe vlerat e synuara të përcaktuara në Aneksin XVII, pikat për marrjen e kampionëve duhet të vendosen në territore që zbatimi i TMM mund të monitorohet.
5. Gjithashtu pikat për marrjen e kampionëve duhet, kur është e mundur, të jenë përfaqësuese të vendeve të njëjta jo në afërsinë e tyre direkte. Kur duhet ato duhet të bashkë-lokalizohen më pikat për marrjen e kampionëve për PM10.

II. Përcaktimi i territorit në shkallë mikro

1. Udhëzimet e mëposhtme duhen plotësuar derisa të jenë të praktikueshme:
 - a. rrjedha përreth sondës hyrëse të marrjes së kampionëve duhet të jetë e pakufizuar, pa ndonjë pengesë që ndikon rrjedhën e ajrit në afërsi të shabllonit (normalisht disa metra larg nga ndërtesat, ballkonet, pemët dhe pengesa të tjera dhe të paktën 0,5 m larg nga ndërtesa më e afërt në rastin e pikave për marrjen e kampionëve që përfaqësojnë cilësinë e ajrit në vijën e ndërtesës);
 - b. në përgjithësi, pika hyrëse për marrjen e kampionëve duhet të jetë midis 1,5 m (zona e frymëmarrjes) dhe 4 m mbi tokë. Pozicionet më ta larta (deri në 8 m) mund të jenë të nevojshme në disa rrethana. Përcaktimi i territoreve më ta larta mund të jetë gjithashtu i përshtatshëm nëse stacioni është përfaqësues i një zone të madhe;
 - c. sonda hyrëse nuk duhet pozicionuar në afërsi direkte të burimeve me qëllim që të shmanget futja direkte e shkarkimeve të papërziera me ajrin e ambjentit;
 - d. dalja e shkarkimit të shabllonit duhet të pozicionohet në mënyrë të tillë që të shmanget riqarkullimi i ajrit të shkarkimit në hyrjen e kampionit;
 - e. pikat e marrjes së kampionëve të orientuara nga trafiku duhet të jenë të paktën 25 metra nga skaji i kryqëzimeve të mëdha dhe të paktën 4 m nga qendra e korsisë më të afërt të trafikut; hyrjet duhet të pozicionohen në mënyrë të tillë që të jenë përfaqësuese të cilësisë së ajrit pranë vijës së ndërtesës;
 - f. për matjet e depozitës në zonat me karakter rural, udhëzimet EMEP dhe kriteret duhet të zbatohen aq sa janë të praktikueshme dhe kur nuk përcaktohen në Anekse.
2. Faktorët e mëposhtëm mund të merren gjithashtu në konsideratë:
 - a. burimet interferuese;
 - b. sigurimi;
 - c. aksesit;
 - d. disponueshmëria e energjisë elektrike dhe komunikimeve telefonike;
 - e. vizibiliteti i territorit në lidhje me rrethinat përreth tij;
 - f. siguria e publikut dhe operatorëve;

g. dëshirueshmëria e pikave të bashkëlokalizuara për marrjen e kampionëve për ndotës të ndryshëm;

h. kërkesat për planifikim.

III. Dokumentacioni dhe rishikimi i përzgjedhjes së territorit

1. Proçedurat për përzgjedhjen e territorit duhet të jenë plotësisht të dokumentuara në fazën e klasifikimit nga mjete të tilla si fotografitë e gjithë perimetrit të zonave rrethuese dhe një hartë e detajuar. Territorët duhet të rishikohen në intervale të rregullta me dokumentacion të përsëritut për të siguruar që kriteret e përzgjedhje mbeten të vlefshme me kalimin e kohës.

IV. Kriteret për përcaktimin e numrave të pikave për marrjen e kampionëve për matjen fikse të përqendrimeve të arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit në ajrin e ambjentit

1. Numri minimal i pikave për marrjen e kampionëve për matje fikse për të vlerësuar respektimin e vlerave të synuara për mbrojtjen e shëndetit të njeriut në zonat dhe agregatët ku matja fikse është burimi i vetëm i informacionit.

(a) Burimet e shpërhapjes

Popullsia e agregatit apo zonës (mijëra)	Nëse përqendrimet maksimale tejkalojnë pragun e sipërm të vlerësimit (1)		Nëse përqendrimet maksimale janë midis pragjeve të sipërme dhe të poshtme të vlerësimit	
	As, Cd, Ni	B(a)P	As, Cd, Ni	B(a)P
0–749	1	1	1	1
750–1 999	2	2	1	1
2 000–3 749	2	3	1	1
3 750–4 749	3	4	2	2
4 750–5 999	4	5	2	2
≥ 6 000	5	5	2	2

(1) Të përfshihet të paktën një stacion në mjedis urban dhe për benzo(a)pirenin gjithashtun një stacion i orientuar nga trafiku me kusht që kjo nuk e rrit numrin e pikave të marrjes së kampionëve.

(b) Burimet pikë

1. Për vlerësimin e ndotjes në afërsi të burimeve pikë, numri i pikave për marrjen e kampionëve për matje fikse duhet të përcaktohet duke marrë parasysh dendësitë e shkarkimeve, modelet e mundshme të shpërndarjes së ndotjes në ajrin e ambjentit dhe ekspozimin potencial të popullsisë.
2. Pikat për marrjen e kampionëve duhet të jenë në territore të tilla në mënyrë që zbatimin i teknikave më të mira të mundshme (TMM) të mund të monitorohet.

ANEKSI XX. Objektivat për cilësinë e të dhënave dhe kërkesat për modelet e cilësisë së ajrit

I. Objektivat për cilësinë e të dhënave

Objektivat e mëposhtme për cilësinë e të dhënave duhen përdorur si udhëzues për sigurimin e cilësisë.

	Benzo(a)pireni	Arseniku, kadmiumi dhe nikeli	Hidrokarburet aromatike policiklike përveç benzo(a)pirenit, mërkuri i gaztë total	Depozitimi total
— Pasiguria				
Matjet fikse dhe treguese	50%	40%	50%	70%
Modelimi	60%	60%	60%	60%
— Kapja minimale e të dhënave	90%	90%	90%	90%
— Mbulimi i kohës minimale:				
Matjet fikse	33%	50%		
Matjet treguese (*)	14%	14%	14%	33%

(*) Matje treguese që janë matje që kryhen në periudha të rregullta të reduktuara por që plotësojnë objektivat e tjera për cilësinë e të dhënave.

1. Pasiguria (shprehur në nivelin e konfidencës 95 %) e metodave të përdorura për vlerësimin e përqendrimeve të ajrit të ambjentit do të vlerësohet në përputhje me parimet e Udhëzuesit CEN për shprehjen e pasigurisë në matje (ENV 13005-1999), metodologjia e ISO 5725:1994, dhe udhëzuesi i ofruar në Raportin CEN Report, 'Cilësia e ajrit — Përjasje në vlerësimin e pasigurisë për metodat referencë të matjeve të ajrit të ambjentit (CR 14377:2002E). Përqindjet për pasigurinë jepen për matje individuale, që mesatarizohen përgjatë kohërave tipike të marrjes së kampionëve, për intervalin e konfidencës prej 95 %. Pasiguria e matjeve duhet interpretuar si të jetë e aplikueshme në rajonin e vlerës së duhur të synuar. Matjet fikse dhe treguese duhet të shpërndahen në mënyrë të njëtrajtshme përgjatë vitit me qëllim që të shmanget shtrembërimi i rezultateve.
2. Kërkesat për kapjen minimale të të dhënave dhe mbulimin e kohës nuk përfshijnë humbjet e të dhënave për shkak të kalibrimit të rregullt apo mirëmbajtjes normale të përdorimit të instrumentave. Marrja e kampionëve njëzet e katër orë kërkohet për matjen e benzo(a)pirenit dhe hidrokarbureve të tjera aromatike policiklike. Me kujdës, kampionët individualë të marrë gjatë një periudhe deri një mujore mund të kombinohen dhe analizohen si një kampion i përbërë, me kusht që metoda të sigurojë që kampionët të jenë të qendrueshëm për atë periudhë. Mund të jetë e vështirë të zgjidhen analitikisht tre përbërjet me

prejardhje të njëjtë benzo(b)fluoranteni, benzo(j)fluoranteni, benzo(k)fluoranteni. Në raste të tilla ato mund të raportohen si shumë. Marrja e kampionëve njëzet e katër orë është gjithashtu e këshillueshme për matjen e përqendrimeve të arsenikut, kadmiumit dhe and nikelit. Marrja e kampionëve duhet të shpërndahet në mënyrë të njëtrajtshme gjatë ditëve të javës dhe vitit. Për matjen e normave mujore ose javore të depozitimit, rekomandohen kampionë gjatë vitit.

3. Ministria mund të përdorë marrjen e kampionëve të njomë në vend të atyre voluminozë nëse mund të demonstrojë që ndryshimi midis tyre është brenda 10 %. Normat e depozitimit në përgjithësi duhet të jepen si $\mu\text{g}/\text{m}^2$ në ditë.
4. Ministria mund të zbatojë një mbulim kohor minimal më të ulët se sa a ii treguar në tabelë, por jo më i ulët se sa 14 % për matje fikse dhe 6 % për matjet treguese me kusht që të mund të demonstrohet që 95 % pasiguri e shfaqur për mesataren vjetore, llogaritur nga objektivat për cilësinë e të dhënave në tabelë sipas ISO 11222:2002 — 'Përcaktimi i pasigurisë së mesatares së kohës për matjet e cilësisë së ajrit' do të përmbushet.

II. Kërkesat për modelet e cilësisë së ajrit

1. Në rastet kur përdoret për vlerësim një model për cilësinë e ajrit, hartohen referenca për përshkrimet e modelit dhe informacion për pasigurinë. Pasiguria për modelimin përkufizohet si shmangia maksimale e niveleve të përqendrimit të matur dhe të llogaritur, përgjatë një viti të plotë, pa marrë parasysh kohën kur ndodhin ngjarjet.

III. Kërkesat për teknikat e vlerësimit të objektivit

1. Në rastet kur përdoren teknikat e vlerësimit të objektivit, pasiguria nuk duhet të tejkalojë 100 %.

IV. Standartizimi

1. Për substancat që do të analizohen në fraksionin PM10, vëllimi i marrjes së kampionëve i referohet kushteve të ambjentit.

ANEKSI XXI. Metodat referencë për vlerësimin e përqendrimeve në ajrin e ambjentit dhe normat e depozitimit

I. Metoda referencë për marrjen e kampionëve dhe analizën e arsenikut, kadmiumit dhe nikelit në ajrin e ambjentit

1. Metoda referencë për matjen e përqendrimeve të arsenikut, kadmiumit dhe nikelit në ajrin e ambjentit ëshë aktualisht duke u standartizuar nga CEN dhe do të bazohet në marrjen manuale të kampionëve PM10 ekuivalentë me EN 12341, pasuar nga tretja e kampionëve dhe analiza nga Spektrometria e Absorbimit Atomik apo Spektrometria e Masës ICP. Në mungesë të një metode të standarteve CEN, Ministria përdor metodat e standarteve kombëtare ose metodat e standarteve ISO.
2. Ministria mund të përdorë gjithashtu çdo lloj metode tjetër që mund të demonstrojë se jep rezultate të barasvlefshme më metodën e mësipërme.

II. Metoda referencë për marrjen e kampionëve dhe analizën e hidrokarbureve aromatike policiklike në ajrin e ambjentit

1. Metoda referencë për matjen e përqendrimeve të benzo(a)pirenit në ajrin e ambjentit ëshë aktualisht duke u standartizuar nga CEN dhe do të bazohet në marrjen manuale të kampionëve PM10 ekuivalentë me EN 12341. Në mungesë të një metode të standarteve CEN për benzo(a)pirenin apo hidrokarbure të tjera përkatëse aromatike policiklike, Ministria përdor metodat e standarteve kombëtare ose metodat ISO siç është standarti ISO 12884.
2. Ministria mund të përdorë gjithashtu çdo lloj metode tjetër që mund të demonstrojë se jep rezultate të barasvlefshme më metodën e mësipërme.

III. Metoda referencë për marrjen e kampionëve dhe analizën e mërkurit në ajrin e ambjentit

1. Metoda referencë për matjen e përqendrimeve të mërkurit të gaztë total në ajrin e ambjentit do të jetë një metodë e automatizuar bazuar në Spektrometrinë e Absorbimit Atomik ose Spektrometrinë e Fluoreshencës Atomike. Në mungesë të një metode të standarteve CEN, Ministria përdor metodat e standarteve kombëtare ose metodat e standarteve ISO.
2. Ministria mund të përdorë gjithashtu çdo lloj metode tjetër që mund të demonstrojë se jep rezultate të barasvlefshme më metodën e mësipërme.

IV. Metoda referencë për marrjen e kampionëve dhe analizën e depozitimit të arsenikut, kadmiumit, mërkurit, nikelit dhe hidrokarbureve aromatike policiklike

1. Metoda referencë për marrjen e kampionëve të arsenikut, kadmiumit, mërkurit, nikelit dhe hidrokarbureve aromatike policiklike të depozituara duhet bazuar në ekspozimin e instrumentave matës të depozitës cilindrike

me përmasa të standartizuara. Në mungesë të një metode të standartizuar CEN, Ministria mund të përdorë metoda të standarteve kombëtare.

V. Teknikat e modelimit referencë për cilësinë së ajrit

1. Teknikat e modelimit referencë për cilësinë e ajrit nuk janë specifikuar për momentin.